Ligji nr. 03/l-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja	Ky ligj ka për qëllim të rregulloj dhe garantoj të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, d uke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit. Po ashtu përcakton edhe kompetencat e komunave për menaxhimin e cilësisë së ajrit.
Ligji nr. 02 /l-102 për mbrojtjen nga zhurma	Qëllimi i këtij ligji është shmangia, parandalimi ose zvogëlimi në baza prioritare të ndikimeve të dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen si rezultat i ekspozimit ndaj zhurmës. Ligji përshkruan edhe kompetencat e komunave për rregullimin e problemeve nga zhurma.
Ligji nr. 04/L-060 për mbeturina	Ky ligj rregullon menaxhimin e mbeturinave, planet për menaxhimin e mjedisit, të drejtat dhe detyrimet e personave të licencuar të cilët merren me menaxhimin e mbeturinave, mënyra dhe kushtet e mbledhjes së mbeturinave, transportit, trajtimit, përpunimit, magazinimit dhe deponimit përfundimtar, importin, eksportin dhe transitin e mbeturinave, monitorimin, sistemin informativ dhe financimin. Ligji definon edhe kompetencat e komunave për menaxhimin e mbeturinave.
Ligji nr. 03/l-153 për pyjet e Kosovës	Ky ligj i definon pyjet e Kosovës si resurse kombëtare, andaj ka për qëllim që ato të udhëhiqen në atë mënyrë që të ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme. Ligji definon edhe kompetencat dhe detyrat e komunave për menaxhimin e pyjeve.

Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale	Ky ligj përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror
--	--

Në tabelën 2 janë prezantuar dokumentet planifikuese dhe strategjike të komunës së Podujevës që janë marrë në konsideratë gjatë përcaktimit të objektivave dhe aktiviteteve të PLVM.

Tabela 2: Dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Podujevës (Komuna e Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>)

Dokumenti	Qëllimi dhe fushëveprimi
Statuti i Komunës së Podujevës	Rregullon organizimin e brendshëm të komunës dhe përcakton përgjegjësitë vetanake të organeve komunale.
Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Podujevës 2016- 2026	Planit Zhvillimor Komunal është një projekt strategjik për komunën dhe të ardhmen e saj. Projekti përcakton kahet e zhvillimit të ardhshëm të komunës, duke adresuar të gjitha problemet hapësinore dhe gjithashtu jep zgjidhjet e dëshiruara të këtyre problemeve përmes strategjisë së këtij plani, e cila duhet të realizohet në hapësirë dhe kohë të caktuar. Gjithashtu, hartimi i Planit Zhvillimor Komunal është edhe obligim ligjor për të gjitha komunat e Kosovë në bazë të Ligjit mbi ndryshimin e ligjit për planifikim hapësinor.
Harta Zonale Komunale e Komunës së Podujevës 2022 - 2030	Qëllimi i Hartës Zonale të Komunës (HZK) është përveç përmbushjes së kërkesës ligjore, t'i ofrojë qeverisjes komunale një instrument për kontroll të zhvillimit. HZK është dokument multi-sektorial me karakter rregullues, përmes së cilës definohet në hollësi ndarja e territorit të komunës së Podujevës në zona (të tilla si hapësirat e lira, banim, industri, bujqësia, aktivitete ekonomike, etj), ku për secilën zonë përcaktohen shfrytëzimet e lejuara dhe ato të ndaluara të tokës, kushtet zhvillimore dhe ato të ndërtimit si dhe masat e veprimit për periudhën së paku 8 vjeçare

Plani Lokal Për Veprim Në Mjedis 2012 - 2017	Plani Lokal I Veprimit në Mjedis (PLVM) është dokument i politikës mjedisore vendore, të cilat paraqesin prioritete mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Përgatitja e këtij plani zhvillon më tej aftësitë e pushtetit vendor dhe subjekteve të tjera të interesuara për mjedisin dhe komunitetin. Gjithashtu, PLVM nxit bashkëpunimin midis shoqërisë civile, publikut, pushtetit vendor dhe atij qendror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe
	pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.
Plani Lokal I Menaxhimit të Mbeturinave I Komunës së Podujevës 2017- 2022	Qëllimi i kryesor është krijimi i një kornize masash, të cilat do të synojnë zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që krijohen në burim, zvogëlimin e sasisë së tyre që shkojnë në deponi dhe zhvillimin e një infrastrukture për ngritjen e një sistemi të integruar për menaxhimin e mbeturinave. Gjatë periudhës kohore 10 vjeçare 2013-2022 të zbatimit të saj, strategjia ka vendosur tre periudha kohore të rëndësishme (2015 – 2019 – 2022).
Rregullore Për Mbrojtjen e Mjedisit Në Komunën e Podujevës	Me këtë rregullore është krijuar baza juridike për mbrojtjen e mjedisit në nivel lokal për qytetarët e Komunës së Podujevës, në mënyrë që të jetë e përbalueshme dhe në përputhshmëri me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunës.

1.5 Qëllimi dhe objektivat e PLVM-së

Qëllimi i përgjithshëm i Planit Lokal për Veprim në Mjedis për komunën e Podujevës është që të identifikoj problemet mjedisore, të përcaktojë **prioritetet** në sektorin e mjedisit dhe të ofrojë zgjidhje për problemet **prioritetet** mjedisore, duke synuar një menaxhim më efektiv të tyre, duke i vendosur ato në agjendën e institucioneve përgjegjëse. Objektivat specifike të planit janë:

- Ø Të bëjë vlerësimin dhe analizën e gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe ndikimeve në mjedis nga sektorët e ndryshëm zhvillimor;
- Ø Të identifikoj dhe përcaktoj problemet dhe mangësitë kryesore mjedisore në territorin e komunës së Podujevës;
- Ø Të identifikoj dhe përcaktoj prioritetet kryesore që do të adresohen në kuadër të PLVM-së për periudhën 5 vjeçare dhe **rekomandimet** për përmirësimin e gjendjes;

- Ø Të planifikohen dhe përcaktohen afatet, aktivitetet dhe projektet që do të ndërmerren për adresimin e prioriteteve të identifikuara si dhe indikatorët përkatës për monitorimin e zbatimit të planit dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

1.6 Procesi dhe Metodologjia për përgatitjen e PLVM-së

Në kuadër të aktiviteteve për hartimin e këtij plani, Komuna e Podujevës , ka ndërmarr këto veprime: Kryetari i Komunës së Podujevës ka miratuar vendim për hartimin e PLVM-së, me qëllim që të koordinojë aktivitetet për hartimin dhe miratimin e tij. Sipas Vendimit bartës të **aktivitetit** gjatë procesit të hartimit të PLVM-së është caktuar Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Drejtoria në fjalë ka hartuar një plan dinamik për mbledhjen e të dhënave dhe koordinimin e aktiviteteve për hartimin e planit. Metodologjia e hartimit të planit dhe përcaktimit të prioriteteve të tij është orientuar duke u bazuar në:

- Ø Identifikimin e problemeve kryesore në mjedisin e komunës së Podujevës që vijnë nga sektorët e **ndryshëm** zhvillimorë bazuar në të dhënat ekzistuese dhe trendet e tyre.
- Ø Analizën dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit në Komunën e Podujevës ku është bërë prezantimi i gjendjes aktuale mjedisore bazuar në të dhënat në dispozicion. Në kuadër të analizës së gjendjes është prezantuar gjendja e **komponentëve** mjedisor. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore që ka komuna dhe ndikimeve në mjedis nga sektorët e ndryshëm.
- Ø Identifikimi i problemeve kryesore mjedisore të cilat do të trajtohen për zgjidhje në kuadër të PLVM-së duke marrë për bazë kapacitetet financiare dhe zhvillimore të komunës dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre.
- Ø Duke u bazuar në këto probleme mjedisore janë përcaktuar prioritetet mjedisore për periudhën 5 vjeçare dhe janë grupuar ato sipas tematikave përkatëse mjedisore.
- Ø Bazuar në prioritetet kryesore mjedisore është propozuar edhe plani i veprimeve për përmbushjen e këtyre prioriteteve, që do t'i shërbejnë komunës për të hartuar projektet konkrete të mbështetura nga buxheti i komunës apo nga sigurimi i fondeve nga donatorët.
- Ø Për të siguruar një implementim më efikas të PLVM është propozuar Plani i monitorimit për zbatimin e tij, ku janë përcaktuar edhe treguesit përkatës të monitorimit sipas prioriteteve.

2. Profili I Komunës

2.1 Pozita Gjeografike e komunës



Harta 1. Pozita Gjeografike e komunës së Podujevës

Llapi si rajon është i rrethuar me male. Nga ana perëndimore kufiri paraqet një vije natyrore kufizuese kundrejt komunës së Mitrovicës, sepse i mbahet shpateve lindore të maleve të Shalës së Bajgores. Nga ana veriore dhe lindore shtrihen malet, të cilat e ndajnë rajonin e Llapit nga Serbia, ku edhe Qafa e Përpellacit, Qafa e Merdarit dhe Qafa e Tullarit, ndërsa nga ana e jugut luginës së Llapit del në Fushën e Kosovës, e cila fillon nga fshati Besi-Barilevë. Territori i Llapit


është vend malor, por e ka edhe fushëgropën e Llapit si toke pjellore. Llapi si tërësi mikrogjeografike ndahet në tri pjesë:

1. Fushëgropa e Llapit, e cila shtrihet prej fshatit Repë në veri dhe në jug deri te fshati Besi-Barilevë, me një gjatësi prej më se 35 km dhe në një gjerësi prej 12-15 km në vijën Batllavë-Llapashticë e **Epërme**.
2. Gryka e Llapit, e cila përfshinë territorin prej fshatit Repë deri në fshatin Murgull, me një gjatësi prej rreth 14 km, dhe nga Bellasica deri te Kepi i Uglarit, që është rreth 14 km në gjerësi dhe
3. Gallapi i Llapit, i cili shtrihet nga fshati Batllavë e deri në fshatin Medergofc dhe nga fshati Turuqicë deri në Keqekollë dhe Koliq.

Rajoni i Llapit ka lartësinë mesatare prej 826 m. në vetëm 4,8km të **sipërfaqes** së Llapit. Ky territor ka ma shumë vise kodrinore- malore. Komuna e Podujevës ka sipërfaqe prej: 632.97.km², është qendër e urbanizuar dhe përveç saj janë edhe 76 fshatra. Podujeva me rrethinë shtrihet në shkallen prej 42-41-35 deri 43-08-13 të gjatësisë gjeografike veriore dhe 20-58–35 deri 21-26-35 të gjatësisë gjeografike lindore. Territori i rajonit të Llapit fillon nga Kepi i Uglarit dhe shtrihet rrjedhës së lumit Llap i cili e lidh me Kosovën dhe me qafën e Përpellacit me Nishin (shteti I Serbisë). Territori i rajonit të Llapit ka pozite të rëndësishme gjeografike e strategjike. Në këtë mënyrë, ky territor ndodhet në qendër të Ballkanit. Nëpër rajonin e Llapit kalon rruga transitore që e lidh Kosovën me magjistralen e Adriatikut dhe magjistralen e Shkupit. Podujeva si qendër me e rëndësishme e Llapit, nga Prishtina është larg 30 km. Me Prishtinën lidhet me vijën hekurudhore që nga viti 1948. Nga Podujeva degëzohen rrugët rajonale. Prej tyre me të **rëndësishmet** janë: Podujeve-Kërpimëh-Pollate dhe Lluzhan-Orllan. Në këtë rajon janë 20 km rruge magjistrale, 100 km rruge rajonale dhe 150 km rrugë lokale. Podujeva është e ngritur në qendër të fushëgropës së Llapit në lartësi absolute prej 608 m të lartësisë mbidetare dhe karakterizohet si vendbanim subalpin. Për trojet etnike shqiptare është me rëndësi të veçantë strategjia kufitare me Serbinë. Pozita gjeografike e këtij rajoni ka qenë me rëndësi edhe gjatë historisë që nga koha e lashtë. Në aspektin kadastral në bazë të të dhënave nga AKK komuna e Podujevës ka 78 Zona Kadastrale (Kk **Podujevë** 2024).

2.2 Gjeologjia dhe Relievi

2.2.1 Gjeologjia



Harta 2. Gjeologjia e Terrenit në Komunës së Podujevës (Pzhk Podujevë)

Kufijtë natyror fiziko-gjeografik të kësaj hapësire bëjnë pjesë në zonën tektonike të Vardarit, duke u përfshirë në **nën zonën** Qendrore dhe atë të Jashtme të saj. Pikërisht me këtë shtrirje gjeologjike lidhet një përbërje litologjike e larmishme dhe trajta tejet të ndryshme të deformimeve të tyre, përfshi strukturat rrudhosëse dhe ato shkëputëse. Trajtimi i tyre ka një rëndësi të veçantë, pasi nëpërmjet të tyre është realizuar formimi dhe evolucioni morfotektonik dhe morfoklimatik i relievit në tërësi të kësaj pjese. Kontaktet tektonike ndërmjet këtyre dy **nën zonave**, të cilat përgjithësisht kushtëzojnë edhe ndarjen midis njësive morfologjike VL (Gollakut e pellgun e Llapit) dhe atyre JP (Kopaonikun dhe pjesën VP të Fushës së Kosovës), janë të tipit të mbihipjes. Kjo dukuri tektonike ka ndikuar drejtpërdrejtë në krijimin e brezave të fuqishëm të shkatërrimit midis shkëmbinjve terrigjen dhe atyre magmatikë, të cilët paraqiten me rëndësi të veçantë në drejtim të evolucionit morfologjik të relievit të kësaj zone. Shtrirjen shumë më të gjerë hapësimore e ka **nën zona** Qendrore, e cila ndërtohet kryesisht nga shkëmbinjte

magmatikë të jurasikut e miocenit, pastaj ato terrigjen të metamorfizuar të paleozoit dhe të kretakut (Sh. Bulliqi 2006).

Kurse nën zona tektonike e brendshme, e cila përfshinë kryesisht relievin kodrinoro-malor të Gollakut dhe pellgun e Llapit, ndërtohet në pjesën më të madhe prej shkëmbinjve flishor të metamorfizuar të kretakut dhe pjesërisht nga magmatikët efuziv të jurës. Kështu ndryshimi i këtyre dy nënzoneve vërehet se te kjo e fundit mbizotërojnë shkëmbinj të terrigjen, kurse te ajo qendrore magmatike, duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë edhe në morfogjenezë. Natyrisht ndryshimi më i rëndësishëm midis këtyre dy nënzoneve është ndryshimi i theksuar i vlerave të diferencimit tektonik të ri të strukturave të tyre, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në veçoritë morfologjike të kësaj pjese.

Sipas Pzhk-së Komuna e Podujevës nga aspekti gjeologjik është e ndërtuar prej formacioneve të ndryshme. Marrin pjesë formacione të Paleozoikut, Triasiku, Jurasiku, Kretaku i Sipërm, Neogjenit, Pliocenit dhe sedimentet e Kuaternarit

Paleozoiku - Formacionet me të vjetra janë ato të rreshpeve sericite dhe filite të cilat ndërtojnë një brez në luginën e lumit Kaqanodoll, përkatësisht shtrihen në komunat e kadastrave Lupç i Poshtëm, pjesën perëndimore të Majacit, Lupç i Epërm dhe pjesën perëndimore të Popovës. Në pjesën lindore paraqiten shkëmbinj të acid dhe të ndërmjetëm si janë: granitet, dacitet, riolit etj. Këto formacione shtrihen kryesisht në vendbanimet Orllan Turuqicë, Muhazob etj. Jurasiku - formacionet e Jurasikut shtrihen pothuajse paralel me ato të paleozoikut. Përbëhen nga formacioni diabaz stallor dhe nuk ka shtrije aq të madhe në këtë komunë. Kanë shtrirje gjatësore prej Bellopoje në jug deri në Tërnavicë në veri. Në disa vende janë të ndërprera me formacione tjera. Përgjatë prishjeve të reja tektonike në kontak me formacionet e jurasikut paraqiten serpentinitet që nuk kanë shtrirje të madhe. Hasen në lokalitetet: Dobratin, Katunisht, Sallabajë, Zhiti etj.


Kretasiku - Në territorin e Podujevës janë mjaftë të përhapura formacionet e kretasikut të cilat përfaqësohen me disa njësi. Kretaku i poshtëm shtrihet si në pjesën veriore, verilindore dhe vazhdon kah jugu me një brez i cili tutje kah jugu zgjerohet dhe arrin deri te fshatrat Dyz dhe Brainë. Përfaqësohet prej formacioneve alevrolite, mergelet, gëlqerorët konglomeratik. Kretaku i sipërm senonian shtrihet në pjesën jugperëndimore të komunës. Përfaqësohet nga konglomeratet, mergelet, argjilitet, gëlqerorët ranor etj. Plioceni – shtrihet në pjesën e ulët të komunës,

përkatësisht në fushëgropën e Llapit. Shtrihet në të dy anët e Lumit Llap. Është i përfaqësuar me zhavorre, rëra, argjila, mergele, etj. Kompaktësinë e këtij formacioni e prishë lumi Llap, Dumnica, Batllava ku janë shtresuar formacione tjera. Kuaternari - Sedimentet aluviale, në formë të terracës lumore, janë të përfaqësuara përgjatë të dy anëve të rrjedhave ujore dhe përbëhen nga zhavorret, rëra, dhe suargjillat. Zhavorri përbëhet nga zajet (guralecët) e kuarcit dhe shkëmbinjtë metamorfik. Sedimentet deluviale janë konstatuar në pjesën veriore të komunës, përkatësisht në rrëzë të shpateve malore (Metehi, Godishnjak, Penuhë). Sedimentet aluviale janë prezentë përgjatë të dy anëve të rrjedhave lumore dhe degëve të tyre, që përfaqësohen nga depozitimet zhavorreve dhe rërës. Shtrirja e këtyre sedimenteve si për kah trashësia ashtu edhe gjerësia është e ndryshme (*Pzhk Podujevë 2016 - 2025*).

2.2.2 Relievi

Karakteristikat morfologjike - Rrethi i Llapit përbëhet nga tri tërësi. Relievi malor i jep karakteristikën e hapësirës gjeografike. Kategorisë së territorit kodrinor dhe malor i përkasin 3/4 e sipërfaqes dhe për këtë cilësohet rajon me pak fushor. Nga tri anët shtrihen malet dhe vetëm në derdhjen e lumit Llap lidhet me Fushën e Kosovës. Rajoni i Llapit ka lartësinë mesatare prej 826 m dhe për 4 m është me i ulët se rajoni i Kosovës. Pamja e përgjithshme ndryshon për shkak të përbërjes morfologjike dhe gjeologjike.

Ne anën veriore dhe ne anën perëndimore ngritën malet që i përkasin sistemit të maleve të Argjendta (Kopaunikut). Pjesa e maleve me të larta të këtij sistemi shtrihen me ne perëndim, në kufi me Shalën e Bajgores, respektivisht me komunën e Mitrovicës dhe Vushtrrisë si: Maja e Mprehte e Ostrokopja (1.879 m), Bareli (1.583 m), Mali i Ukshin Kovaqices (1.379 m), Kepi i Sokolit, Mali i Mus Popoves, Gerdeci (838 m), Hunda e Lugut (763 m). Në pjesën lindore të Llapit janë këto male: Mali i Uglarit ose Kepi i Uglarit (1.297 m), Kertinjaku (1.147 m), Perpellaci (947 m), Mali i Kravarices (963 m), Malet e Batllavës (1.213 m), Mali i Merkonjes (1.017 m), Mali i Brainës (933 m), Gallapi, Suka e Shakovicës (671 m) dhe Mali i Rumanishtes. Te gjitha këto male ndahen njeri prej tjetrit në formë të izoluar kodrinore dhe malore dhe shpesh me lumenj malor. Këta lumenjë e kanë bërë erozionin duke formuar lugina të thella sidomos në malet e sistemit të Malit të Argjendte, në pjesën veriore dhe perëndimore.



Harta 3. Relievi në komunën e Podujevës

Pamjes morfologjike i ka paraprire predispozicioni i lëvizjeve tektonike të kohës së terciarit, kur në shtresat gëlqerore janë formuar shtresa të trasha të shkëmbinjve vullkanik, të cilët, si rezultat i proceseve postvullkanike, janë bartës të xehes së plumbit e të zinkut. Këto xehe janë shfrytëzuar gjatë historisë në Labucë, afër burimit të lumit Llap.

Qafat dhe vendkalimet më të njohura që e lidhin Llapin me viset tjera janë: rruga që kalon në perëndim të Kepit të Uglarit dhe lidhet me Banjën e Llukovës e pastaj vijën Qafa e Tashefcit, Qafa e Përpellacit (814m), Qafa e Merdarit dhe Qafa e Tullarit. **Nëpër këto** vende lidhjet bëhen


me Serbinë. Neper Ballaban-Keqekollë-Qafa e Bubarit të Thate lidhet me Prishtinën. Me Prishtinën lidhet edhe me Gryken e Kulinës ose Ngushticën e Teneshdollit. Me Mitrovicën e lidhin Qafa e Gurit të Mullirit, Qafa e Kaqandollit dhe Qafa e Rzhanës.

Tërësinë morfologjike të rajonit të Llapit e përbënë kryesisht fusha aluviale e lumit Llap dhe degëve te tij: lumit te Dumnicës, lumit te Batllavës, lumit te Kacanollit si dhe lumenj dhe përroje të tjera me të vogla. Para fazës liqenore bëhet shfaqja intenizive vullkanike. Nga kjo kohë kanë mbetur tarrca fluviale anësore te brigjeve te lumit Llap dhe me këtë u be ngushtimi i shtratit te lumit. Llapi në pjesën e tij me veriore shtron zallë të trash dhe ne rrjedhën e mesme dhe të poshtme rërë dhe lym. Me këtë toka bëhet pjellore dhe e përshtatshme për bujqësi dhe kopshtar.

2.3 Klima dhe Hidrografia

2.3.1 Klima

Në hartën e klimës së Kosovës bazuar në të dhënat e Institutit hidrometeorologjik të Kosovës llojet e klimave të cilat mbizotrojnë në komunën e Podujevës janë pak a shumë tipike për regjionin e rrafshit të Kosovës: në pjesën Veriore Malore, duke ardhë në pjesën qendrore kah jugu kontinentale, kurse në pjesën lindore dhe jugore klimë e moderuar kontinentale (IHMK). Prej faktorëve mikroklimatik më të rëndësishmit janë fushëgropa e Llapit dhe malet që e rrethojnë nga të gjitha anët. Temperaturat në këtë komunë oscillojnë dhe kanë mjaft dallime mujore dhe sezonale Temperatura mesatare është $9,6^{\circ}\text{C}$, muaji me i ftoftë është janari me temperaturë mesatare $-2,1^{\circ}\text{C}$, muaji më i ngrohtë është korriku dhe gushti me $20,1^{\circ}\text{C}$. Muaji më i ftoftë me temperaturë ekstreme është janari me $-27,2^{\circ}\text{C}$, ndërsa muaji me temperaturë më të lartë është gushti me $37,0^{\circ}\text{C}$. Amplituda më ekstreme për këtë periudhe është $64,2^{\circ}\text{C}$. Në periudhën vegetative paraqiten temperature negative që nganjëherë sjellin dëme në bujqësi. Reshjet paraqesin vetëm një pjesë të qarkullimit të ujit dhe ripërtëritjes së tij për një hapësirë të dhënë sidomos për territorin e komunës së Podujevës. Në territorin e kësaj komune nuk kalon asnjë lumë transit që kishte për ti ushqyer ujërat nëntokësore. Niveli i ujërave në këtë hapësirë varet drejtpërdrejt nga reshjet (Pzhk Podujevë 2016 - 2025).




Harta 4. Klima në komunën e Podujevës

Bazuar në hartën e klimës së komunës së Podujevës shihet që izohijetet me 1000 mm reshje në vit kalojnë në zonën malore me lartësi mbidetare mbi 1500 m kurse duke ardhur më nga qendra këto reshje pakësohen deri në jug ku kalon izohijetja me 700 mm reshje në vit Në Komunën e Podujevës Me së shumti fryjnë erërat veriore, jugore dhe më pak verilindore Reshjet Mesatarisht me borë janë 26 ditë, ndërsa me mbulesë bore janë 48,4 ditë, ose një muaj e gjysmë. Pjesa më e madhe vitit është pa mbulesë bore. Muaji që ka ditë me mbulesë bore më së shumti është shkurti me 11,7 ditë. Shtresa maksimale e borës është mjaft e lartë edhe pse e rrallë,

megjithatë ndodhë ngase shkakton një varg problemesh në jetën e përditshme. Në muajin janar trashësia maksimale e borës mund të jetë edhe 96 cm që jep sinjal të çartë së mund të paralizojë të gjitha aktivitetet (R. Pllana 1981).

2.3.2 Hidrografia



Harta 5. Hidrografia (Ujërat Sipërfaqësore) në Komunën e Podujevës

Territori i komunës së Podujevës ka një rrjet hidrografik i cili i drenon ujërat në drejtim të pellgut të Detit të Zi. Ujërat sipërfaqësor paraqiten në formë të **përroskave**, përrrenjëve burimeve dhe lumenjëve. Nëpër këtë territor buron dhe shtrihet lumi Llap, i cili njëkohësisht është dega më

e rëndësishme e lumit Sitnica. Lumi Llap buron nga malet e Kopaunikut, ndërsa si burim i tij merret bashkimi i lumit Murgulla me atë të Sllatinës në fshatin Pollatë. Mirëpo si degë duhet të merret lumi Murgulla²⁰. Pjesa burimore e lumit rrjedh nëpër lugina relativisht të ngushta dhe të rrëpita. Në fushëgropën e Llapit lumi hyn në fshatin Pollatë ku shpejtësia e lëvizjes zvogëlohet dhe **merr** karakteristika të lumit fushorë. Sistemi lumor i lumit karakterizohet me rrjet relativisht të dendur të rrjetit lumor. Gjerësia e lumit ndryshon për shkak të dinamikës që kanë lumenjtë, ajo sillet në nivele normale rreth 9-12 metra në pikën hidrometrike në Lluzhan, thellësi deri në 1,2m. Thellësia gjithashtu nuk është e njejtë ngase shtrati ndërtohet nga thellimet ku uji është më i qetë dhe pjesët e cekëta ku thellësia është më e vogël. Gjatësia e këtij lumi në komune është 61 km, ndërsa deri në grykëderdhje në lumin Sitnica 82,7 km. Gjatë reshjeve intesive dhe shkrirjes së borës gjatë stinës së dimrit kur temperaturat rriten, lumi del nga shtrati dhe i përmbytë pjesët rreth tij duke shkaktuar dëme të konsiderushme (*R. Pllana 1981*). Lumi Llap vrojtohet në pika hidrometrike, në Lluzhan dhe në Milloshevë. Pika hidrometrike në Lluzhan funksionon prej vitit 1950 me disa ndërprerje. Në këtë pikë prej vitit 1981 është thelluar shtrati i lumit dhe nivelet janë shënuar me vlera negative (*AMMK 2020*). Treva e Llapit është e pasur edhe me ujëra termo-minerale, si: Burimi mineral në fshatin Sallabaj dhe burimet termo-mineral në Shakovicë (*Plvm Podujevë 2012-2017*).




Figura 1. Lumi Llap në qendrën e qytetit të Podujevës (fotografi Neturale.com)

2.4 Pedologjia dhe Biogjeografia

2.4.1 Pedologjia

Bazuar në të dhënat e hartës Pedologjike të komunës së Podujevës (*DB GIS KPMM 1:200,000*) Komuna Podujevës ka llojllojshmëri të tokave siç janë: toka aluviale, deluviale, rendzinë, ranker, murme argjilore liqenore, e mesme e kuqërremtë, pseudogleje etj. Tokat aluviale, si toka hidromorfike të cilësisë së lartë, shtrihen përgjatë lumit “Llap”, si dhe tokat të tjera që kanë cilësi të mira kultivimi, siç janë: deluviale, e mesme e kuqërremtë, rendzinat shtrihen, po ashtu, në fushëgropën e Llapit me trashësi mbi 25cm - b80> cm.



Harta 6. Pedologjia e komunës së Podujevës

Tipi i llojeve të tjera të tokës kanë përhapje në tërë territorin e Komunës, si: rankere, psudoglej, murrme argjilore etj.

Shpërndarja hapësinore e llojeve të tokave është paraqitur në hartën nr.4. Ku ndikim shihet që ka pasur hidrografia (lumenjtë), relievi, kushtet klimatike, gjeologjia dhe shumë faktorë tjerë të cilët janë përshkruar më lartë.

2.4.2 Biogjeografia

Llojet e tokave (pedologjike), klima, lartësia e shprehur mbidetare kanë ndikuar që të ketë lloje të ndryshme bimore dhe shtazore. Ky biodiversitet më karakteristik është për pjesën e maleve të Kopaunikut. Kjo hapësirë është e pasur me lloje të ndryshme të faunës të cilat nuk janë karakteristike vetëm për këtë zonë. Në ekosistemet pyjore jetojnë:

Ujku (*Canis lupus*), derri i egër (*Sus scrofa*), dhelpra (*Vulpes vulpes*), lepuri (*Lepus europaeus*), iriqi (*Erinaceus europaeus*) etj.

Kohëve të fundit, jo vetëm në këtë hapësirë, ka filluar të paraqitet kaprolli (*Capreolus capreolus*), i cili dikur ka qenë mjaft i përhapur. Prej shpezëve jetojnë mjaft lloje, si: trishtili kokëzi (*Parus major*), zogu i malit, pëllumbi i egër (*Columba livia*), qukapikthi (*Dryobates major*), laraska (*Pica pica*), qyqja (*Cuculus canorus*) etj. Shpezë grabitqare që jetojnë janë: shqiponja e zezë (*Aquila chrysaetos*), petriti (*Falco tinnunculus*). Shpezë shtegtarë që jetojnë janë: dallëndyshja, lejleku (*Ciconia ciconia*) etj.

Në lumenjë jeton gjarpri i ujit (*Natrix natrix*). Gjarpri i gurit (*Vipera ammodytes*) dhe bollujca (*Tropidonatus natrix*) të cilët jetojnë në mjedise të thata si: shkëmbinj, male, lugina etj. Kërmilli i vreshtës (*Helix pomatia*) i cili jeton në vende me lagështi, pyje dhe oborre etj. Po ashtu breshka e rëndomtë (*Testudo hermanni*) e cila jeton kryesisht në pyje të hapura, shkurre, kodrina, vende shkëmbore etj.. Sipas hulumtimeve të bëra nga Gashi 2006, në lumin “Llap” hasen këto lloje të peshqve: trofta (*Salmo trutta m.Fario*), mustaku (*Barbus barbus*), mlyshi (*Squalius cephalus*), gjuca (*Leucaspius delineatus*), barburiqi (*Gobio gobio*), karashi (*Carassius gibelio*), njila (*Chondrostoma nasus*), krap i egër (*Cyprinus carpio*), lloska (*Scardinius erythrophthalmus*), sharroku (*Perca fluviatilis*), lina (*Tinca tinca*) dhe vimba (*Vimba vimba*). Brigjet e liqenit të Batllaves dhe lumit Llap shfrytëzohen për peshkim. Insekte ka shumë lloje, siç janë: fluturat, milingonat që bëjnë koloni dhe janë disa lloje merimanga, kacadreri (*Lucanus cervus*) etj.

Në zonat malore dhe kodrinore malore dominojnë pyjet, ka edhe sipërfaqe të zhveshura e

barishta. Prej drunjëve dallohen pyjet gjetherënëse, siç: ahu (*Fagus sylvatica*), qarri (*Quercus cerris*), bingu, shkoza (*Carpinus orientalis*). Disa trungje sipas Institutit për Mbrojtjen e Natyrës janë shpallur si monumente natyrore, si plepi në **Bajçinë**, plepi Orllan, trugu i qarrit në Pollatë, Dumnicë dhe Dobratin. Trungjet e ahut janë me dimensione mjaft të mëdha (gjatësia dhe trashësia e drurit). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara, si: brekia, bliri (*Tilia cordata*), frashri etj. Përhapje kanë edhe tipet tjera që janë të ulëta, sikurse lloji i shkurreve: thana (**Comus mas**), murrizi (*Crataegus monogyna*), kaça (*Rosa canina*), manaferra e egër (*Rubus fruticosus*), mshtogu (**Sambucus nigra**), kulumbria (*Prunus spinosa*), lajthia (*Corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponje (*Pteridium aquilinum*) etj. Po ashtu edhe disa trungje të tjera: Trugu i shpardhit (*Quercus frainetto*) në Dyz, trungjet e dushkut (*Quercus sp.*) në Llapashticë të Epërme, trugu i dushkut (*Quercus sp.*) në Llapashticë të Epërme, trugu i plepit (*Populus tremula*) në Murgullë, Trugu i plepit (*Populus tremula*) në Gerdoc.

Nga bimët barishtore dallohen lloje të ndryshme, si ato që rriten në ambient të hapur pa presence të drunjëve, si edhe ato që rriten Brenda pyjeve. Këtu rriten edhe bimë që përdoren në mjekësinë popullore, që përdoren, si çaj: çaji i malit (*Origanum vulgare*), kantarioni (*Hypericum perforatum*), kamomili (*Matricaria chamomilla*), dredhëza (*Fragaria vesca*) etj. Prej drunjëve gjethembajtëse janë mbjellur disa hapësira pranë liqenit të “Batllavës”, mandej afër fshatit Dobërdol. Në hapësirat e rrafshëta të Komunës, fushëgropën e “Llapit” zakonisht rritet shelgu (*Salix Alba*) në brigje të lumenjve, si dhe plepi (*Populus tremula*) që u përmend më lartë. Bimë të ulëta ka mjaft, si **lulëkuqja** (*Papaver rhoeas*) që rritet zakonisht në grunaja, hithi (**Urtica dioica**) formacionet e livadheve, si tërfili dhe shkurre të rralla (*Pzhk Podujevë 2016 - 2025*).

Sipas librit të kuq nga AMMK në komunën e Podujevës kemi edhe këto lloje të faunës: Flutura Njollablu e Zezë (Zimbajtësja- *Nymphalis antiopa*) e përhapur në dy lokalitete në Podujevë, Lloji i habitatit: zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore], artiiciale/tokësore (zona urbane). Është lloj që haset në lartësi të ndryshme mbidetare. Në rrethinën e Podujevës është vërejtur edhe në toka të kultivuara. Barkverdha (*Bombina variegata*) e përhapur në disa lokacione Lloji i habitatit: Pyje (pyje boreale, pyje të klimës mesatare), shkurre (shkurre boreale, shkurre të klimës mesatare), kullosa (kullosa të klimës mesatare), vende ujore (kontinentale) (lumenj, përrenj, përroska periodike/të përkohshme/të parregullta, ligatina të dominuara nga shkurret), **artificiale** – ujore (basene të akuakulturës, toka të ujitura [përfshirë kanalet ujitëse]). Zakonisht jetojnë përgjatë lumenjve dhe përroskave ujore, por i

gjejmë dhe në gropa argjile dhe zhavorresh. Mund të hasen në mjedise të ndryshme të lartësive mbi detare, prej 100 deri në 2100 m. Bretkosa e kënetës (*Pelophylax ridibundus*), Lloji i habitatit: shkurre (shkurre boreale, shkurre të klimës mesatare); Vende ujore (kontinentale) (Ligatina të dominuara nga shkurret), shpella dhe habitate 2/2 nëntokësore (jo ujore), artificiale/tokësore (kopshte rurale). Ky lloj kryesisht haset në ujëra të ndenjura. Bretkosa e gjelbër (*Bufo viridis*) Lloji i habitatit: pyje (pyje të klimës mesatare), shkurre (shkurre boreale, shkurre të klimës mesatare), kullosa (kullosa të klimës mesatare), vende ujore (kontinentale) (ligatina të dominuara nga shkurret), artificiale/ tokësore (kopshte rurale, zona urbane), artificiale Ujore (basene të akuakulturës). Ky lloj mund të jetojë në pyje, stepa pyjore, stepa, gjysmëshkretëtira dhe shkretëtira. Mund të gjendet edhe në vende të lagështa, por edhe në vende të thata;

2.5 Shëndeti Publik, Arsimi dhe Mirëqenia Sociale

2.5.1 Shëndetësia

Në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë janë të angazhuar gjithsej 338 punëtorë shëndetësorë. Sa i përket relacionit mes kuadrit shëndetësor dhe popullsisë, Komuna e Podujevës është në mesin e atyre komunave ku relacioni është mesatarisht i ulët (*Instituti Gap 2021*).

Shërbimet në QKMF:

- Ø E Promovimit shëndetësor, informimin, komunikimin dhe edukimin;
- Ø Brenda institucioneve dhe në komunitet;
Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbime tjera parandaluese;
- Ø Shërbime esenciale kurative dhe ndërhyrje të vogëla kirurgjike;
- Ø Shërbime kujdesit shëndetësor për sëmundje kronike;
- Ø Shërbimet e kujdesit akut dhe urgjent;
- Ø Shërbimet e shëndetit mendor;
- Ø Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë , adoleshent dhe të rinjë;
- Ø Shërbimet e shëndetit riprodhues;
- Ø Shërbimet e shëndetit oral dhe parandalues;

- Ø Shërbimet e kujdesit shtëpiak përfshinë shërbimet e kujdesit ndaj nënës dhe fëmijës, kujdesi paliativ si dhe kujdesi shtëpiak bazuar në n nevojat e popullatës dhe prioritetet e shëndetit publik;
- Ø Shpërndarja e barërave nga lista esenciale.

Kurse Struktura e QKMF-së në Podujevë është si vijon:

- Ø Sektori i Mjekësisë Familjare;
- Ø Njësia e SISH-it;
- Ø Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit;
- Ø Sektori I Shëndetit Oral Preventiv;
- Ø Sektori I Kujdesit urgjent;
- Ø Sektori Konsultativ dhe Diagnostik;
- Ø Shërbime konsultative;
- Ø Kabineti Radiologjik;
- Ø Laboratori.

Kurse Departamenti I administratës së QKMF-se organizohet në:

- Ø Njësia ose Zyra e Personelit;
 - Ø Njësia ose Zyra Juridike;
 - Ø Njësia për Buxhet dhe Financa;
 - Ø Njësia ose Zyra për Shërbime Teknike. (DSHMS 2023).
- Shërbimi shëndetësor në komunën e Podujevës është i organizuar ne nivel parësor, këto shërbime ofrohen në QKMF, QMF dhe AMF dhe gjithashtu në sektorin privat si mundësi plotësuese organizative në zhvillimin e sistemin shëndetësor. Institucionet shëndetësore janë të shpërndara dhe mbulojnë me shërbime gjithë territorin e komunës.

Tabela 3. Numri I shërbimeve të kryera në QKMF 2023 - Podujevë

Të dhëna të përgjithshme statistikore për vizitat - shërbimet e kryera në QKMF në vitin 2023	
Qendra (QKMF) Numri I Vizitave	214743
Terreni(QMF, AMF) Numri I Vizitave	48613
Qendra QKMF + Terreni (QMF +AMF) Numri I Vizitave	263356
Qendra (QKMF)+ Terreni (QMF +AMF) Numri I shërbimeve	373588
Totali I vizitave dhe shërbimeve qendër dhe terren	636944

Numri I QKMF, QMF dhe AMF sipas vendbanimeve në komunën e Podujevës:

- Ø QKMF- 1 qytet Podujevë;
- Ø QMF- Lluzhan, Orllan Kërpimeh;
- Ø AMF- Pollatë, Bajqinë, Dobratin, Bradash, Llapashticë, Gllamnik, Dumnicë, Herticë, Shajkoc, Sfeqël, Batllavë, Dyz, Majac, Lupq, Lagja e Kuvajtit, Obranqë, Halabak) (DSHMS 2023).

2.5.2 Arsimi


Në Komunën e Podujevës mësimin e ndjekin 17,600 nxënës në të gjitha nivelet e arsimit para universitar. Për shkak të emigrimit, numri i nxënësve në shkollat e Podujevës ka rënë dukshëm, ku në vitin shkollor 2019/2020 ka 25% më pak nxënës se sa në vitin shkollor 2008/09 (*Instituti Gap 2020*).

Gjithsej në komunën e Podujevës janë 41 Institucione Arsimore, 37 shkolla fillore të mesme të ulëta, 3 shkolla të mesme të larta, 1 institucion parashkollor 16,037 nxënës (2021 – 2022), rreth 1380 të punësuar. Kurse në tabelën e mëposhtme është paraqitur shkollat sipas vendbanimit dhe numrit të nxënësve (*Drejtoria e Arsimit 2022*).

Shkollat e komunës së Podujevës janë të pajisura me infrastrukturë moderne, po ashtu me mjete të punës dhe kabinete të nevojshme për zhvillimin mësimor. Shumica e shkollave janë të pajisura me kompjuter, projektor, kabinete të Muzikës, Kimisë, Fizikës, elemente tjera të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të edukimit sportive, kulturor dhe artistik.

Nr.	Emri i Shkollës	Vendi	Nxënës
1	Aleksandër Xhuvani	Podujevë	1445
2	Isa Boletini	Podujevë	1488
3	Fab S. Noli	Podujevë	710
4	Armela	Podujevë	45
5	Shaban Shala	Podujevë	1102
6	Naim Frashëri	Podujevë	1060
7	Dr. Ibrahim Rugova	Podujevë	1059
8	Enver Maloku	Podujevë	745
9	Ali Ajeti	Sfeqël	605
10	Kongresi i Manastritit	Gllamnik	596
11	Luigj Guraguqi	Batllavë	554
12	Xheladin Rekalju	Podujevë	501
13	Ali Hadri	Obrançë	457
14	Afrimi e Fahriu	Lluzhan	396
15	Hyzriu e Sejdiu	Letanc	358
16	Hamit Sejdiu	Kërpimeh	354
17	Illir Konushevci	Lluga	347
18	Dëshmorët e Kombit	Podujevë	337
19	Shefki Kuleta	Tërrnavë	326
20	Nuhi Gashi	Bradash	305
21	Zenel Hajdini	Lupç i Poshtëm	270
22	Emin Duraku	Bajçinë	253
23	Naum Veçilharxh	Llapashticë e Epërme	251
24	Kadri Kadriu	Llaushë e Epërme	230
25	Pavarsia	Siboc	230
26	Sheqë Mirofci	Shtedim	217
27	Drita	Majac	206
28	Esad Mekuli	Dobratin	201
29	Hasan Ramdani	Shajkoc	189
30	Dituria	Llapashticë e Poshtme	175
31	Lasgush Poradeci	Dumnicë	160
32	Musli Dumoshi	Dumosh	139
33	Eqrem Çabej	Buricë	138
34	Zahir Pajaziti	Orllan	137
35	Jetullah Gashi	Doberdol	124
36	Elfir Behrami	Metehi	109
37	Shefki Latifi	Pollatë	71
38	Rilindja	Hërticë	59
39	Jetullah Islami	Dyz	51
40	Jahë Hasani	Bërvenik	28
41	Sami Frashëri	Zhiti	9
Gjithsej			16037

Tabela 4. Numri I Nxënësve sipas shkollave në komunën e Podujevës



Grafikoni 1. Institucionet Arsimore në bazë të numrit të nxënësve

2.5.3 Mirëqenia Sociale

Në mars të vitit 2021 ishin 4,559 anëtarë të familjeve të Komunës së Podujevës në skemën e ndihmës sociale. Nëse e krahasojmë me të dhënat e vlerësimit të popullsisë në fund të vitit 2019 del se 6% e banorëve të Podujevës janë në skemën e ndihmës sociale (*Instituti Gap 2020*).

Hapja e vendeve të reja të punës do ta ketë efektin e vet duke tentuar në zbutjen e papunësisë, e cila do të arrihet përmes ngritjes së gjithmbarshme të zhvillimit ekonomik. Stimulimi i bujqësisë, përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, do të përmirësojnë situatën sociale. Tërheqja e investitorëve për të investuar në këtë territor gjithashtu do të zbus problemet sociale. Organizimi i trajnimeve profesionale, sipas kërkesave të tregut, do të ndikoj pozitivisht në shkallën e papunësisë dhe varfërisë. Në zonën qendrore aktive zbutja e papunësisë dhe varfërisë do të arrihet duke krijuar kushte të favorshme për bizneset e vogla dhe të mesme pastaj në krijimin e kushteve për tregtarët që kryejnë veprimtaritë e tyre dhe stimulimin e bujqësisë dhe sigurimi i punës sezonale.

Me zhvillimin e veprimtarive bujqësore, industriale dhe komerciale do të krijohen kushte më të mira për jetë, duke e zvogëluar shkallën e papunësisë, varfërisë dhe duke i bërë këto vendbanime përditë e më shumë joshëse për qytetarët (*Pzhk Podujevë 2016 -2025*).


Në qendrën për punë Sociale në Podujevë gjegjësisht në shërbimin social trajtohen raste të ciat ofrohen shërbime social të drejtpërdrejta për përfituesit e këtyre shërbimeve. Qendra për punë social në vitin 2023 ka trajtuar raste si në vijim

- Ø Mbrojtja e fëmijëve të braktisur një rast përgjatë 2023, ndërsa të bartura nga viti paraprak, të cilët janë strehuar familjet strehuese në Komunën e Vitisë dhe Dragashit;
- Ø Strehim Familjar tri raste të reja gjatë 2023, gjithsej nën menaxhim 24 raste;
- Ø Kujdestaria për fëmijë pa përkujdesje prindërore 2 raste të reja gjatë vitit 2023;
- Ø Të mitur në konflikt me ligjin 31 raste të reja përgjatë vitit 2023, prej tyre kanë qenë 27 raste vepra penale, 3 raste sulme seksuale, 1 përdorues I narkotikëve;
- Ø Fëmijë me sjellje Sociale 2 raste;
- Ø Adoptim të fëmijëve 2 raste në vitin 2023;
- Ø Kontaktim prind-fëmijë 5 raste në 2023, kurse nën menaxhim 20 kontakte të bartura nga vitet paraprake;
- Ø Dhunë në familje 49 raste në 2023;
- Ø Bashkim Familjar 6 raste më 2023;
- Ø Këshilla Martesore 6 raste në 2023;
- Ø Besim i Fëmijëve 8 raste më 2023;
- Ø Sanim i marrëdhënieve bashkëshortore 3 raste më 2023;
- Ø Mbrojtja e të moshuarve 1 rast kurse të bartura nga vitet paraprake 4 raste;
- Ø Fëmijë me aftësi të kufizuara 6 raste kurse nën menaxhim 135 raste;
- Ø Klientë të tjerë 277 raste prej tyre;
 - Regjistrim I mëvonshëm I fëmijëve 2 raste;
 - Shpallja e personit të vdekur 6 raste
 - Vërtetim mbi zotësinë e veprimit 103 raste;
 - Vërtetim për lirim nga shtetësia e Kosovës 143 raste;
 - Vërtetim mbajtës I fëmijëve 11 raste;
 - Konstatime zyrtare 12 raste.

Në shërbimin e asistencës sociale në vitin 2023 kemi 693 përfitues së skemës sociale në komunën e Podujevës (DSHMS 2023).

2.6 Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore

2.6.1 Trashëgimia Natyrore



Harta 7. Monumentet e mbrojtura Natyrore në komunën e Podujevës

Gjatë periudhës 1999- 2004 Instituti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës - ka bërë evidentimin e vlerave të reja të natyrës. Njohja dhe evidentimi i vlerave të reja të natyrës është kryer në 12 komuna edhe atë në: Gjakovë, Skenderaj, Drenas, Burim, Rahovec, Kastriot, Vushtrri, Gjilan, Malishevë, Mitrovicë, Klinë dhe Podujevë. Gjatë këtij procesi janë evidentuar 206 vlera të reja

që mund ti përkasin kategorive të ndryshme menaxhuese ndërsa në disa komuna tjera në vitin 2002-2003 (Malishevë, Gjilan, Gjakovë, Podujevë, etj) propozimet e IKMN-së për marrjen e vlerave natyrore nën mbrojtje, janë në procedim (143 objekte) (IKMN 2005). Zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës Zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës përfshijnë:

- Ø Rezervatet strikte të natyrës;
- Ø Parqet kombëtare;
- Ø Zonat e veçanta të mbrojtura të natyrës;
- Ø Zonat e veçanta të ruajtura;
- Ø Parqet natyrore;
- Ø Monumentet e natyrës;
- Ø Peizazhet e mbrojtura;
- Ø Monumentet e arkitekturës së parkut.

Lista e monumenteve të natyrës në komunën e Podujevës, duke referuar regjistrin të MMPHI-së/Institutit për mbrojtje të natyrës është sikur në tabelën vijuese .

Monumente me karakter botanik	Sipërfaqja mbrojtëse	Zona buferike e përfshirë në kuadër të sipërfaqes	Pronësia
Trungu i Qarrit - Pollatë	5 ari	10 m rreth projektionit të kursorës	
Trungu i shpardhit në Dyz	5 ari		Private
Trungu i dushkut në Llapashticë të Epërme	5 ari		Private
Trungjet e dushkut në Llapashticë të Epërme	10 ari		Shoqërore
Trungu i plepit në Murgull	5 ari		Shoqërore
Trungu i plepit në Orllan	5 ari		Komunës
Trungu I Qarrit – Lupç I Poshtëm	5 ari		Private
Trungu i plepit (<i>Populus tremula</i>) Bajqinë	5 ari		
Monumente me karakter hidrologjik			
Burimi i ujit termo-mineral në Shakovicë	1 ha 40 ari 54 m		
Burimi i ujit termo-mineral në Sallabajë	31 ari e 47 m 2		

Monumente me karakter botanik dhe hidrologjik			
Trungu i Ahut dhe Vrella në Dobratin	10 ari	10 m rreth projeksionit të kurorës dhe burimit të ujit	Private
Peizazhe të Mbrojtura			
“Ushton Lumi” në Popovë	92 ha		

Tabela 5. Vlerat e mbrojtura Natyrore në komunën e Podujevës



Figura 2. Peizazh i Mbrojtur në Komunën e Popovës

2.6.2 Trashëgimia Kulturore

PZHK i referohet mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore për të cilat propozon që komuna në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) duhet të përgatis planin menaxhues me qëllim të mbrojtjes së monumentit nga çfarëdo zhvillimi që mund të ketë efekte negative tek ato. PZHK propozon përpilimin e katalogut të hartës për shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore për nevojat e turizmit, dhe vënien nën mbrojtje të lokaliteteve arkeologjike dhe monumenteve historike e ushtarake të luftës së UÇK. Sipas PZHK në komunë ekzistojnë edhe

shumë vlera të trashëgimisë të cilat kanë mbetur jashtë përfshirjes në listën për mbrojtje nga MKRS. Sipas raportit të vlerësimit të zbatimit të PZHK-së, brenda dy viteve të zbatimit të planit është punuar pjesërisht në veprimin vënien nën mbrojtje të lokaliteteve arkeologjike dhe monumenteve historike e ushtarake të luftës së UÇK-së, kurse nuk ka progres të shënuar për hartimin e planit menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve natyrore dhe përpilimi i katalogut turistik për shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Pavarësisht këtyre, vlerësimi ka vënë në pah realizmin e të tjera projekteve që nuk kanë qenë të përfshira me plan si: mbledhjen e ekspozateve në terren, inicimin e trashëgimisë shpirtërore, ekspozita të prezantimit të etno-trashëgimisë dhe fushata sensibilizimi për grumbullimin e ekspozateve të trashëgimisë. Në vijim është dhënë tabela që prezanton vlerat sipas Listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme e vitit 2019 dhe ato të përcaktuara sipas PZHK. Me HZK janë lokalizuar këto vlera dhe për to është përcaktuar zona mbrojtëse sipas përcaktimeve të ligjit respektiv (*HZK Podujevë 2022-2030*).

Tabela 6. Lista e Trashëgimisë Kulturore në komunën e Podujevës

Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike					
A	Nënkategoria: Monument / Ansambël	Periudha	Vendndodhja	PZHK	Lista 2018
1	Lokalitet Arkeologjik	Antikë	Sallabajë	x	x
2	Gërmadhat e Kishës	Mesjetë	Sallabajë	x	x
B	Nënkategoria: Lokalitet arkeologjik/rezevat				
1	Lokalitet arkeologjik-Maja e Llapit ('vërhlab')	Antikitet i vonë	Bellasicë	x	x
2	Varret e vjetra, gjurmët e kishës	Antikitet i vonë, Mesjetë	Pollatë	x	x
3	Lokaliteti arkeologjik- Çuka e Brainës	Antikitet i vonë, Mesjetë	Brainë	x	x
4	Gërmadhat e Kishës 'Perandori Konstantin dhe Perandoreshës Jelena'	Mesjetë	Orllan	x	x
5	Kisha e vjetër e braktisur e Shën Arkangjel Mehillit	Mesjetë	Rakinicë	x	x
6	Lokaliteti arkeologjik Vindenis 'Polanicë'	Romake, antikitet i vonë	Gllamnik	x	x

7	Gërmadhat e kishës së Marisë së Zjarrit	Mesjetë	Batllavë	x	x
8	Lokaliteti arkeologjik-Kalaja (qyteaza)	Antikitët i vonë	Lupç i Poshtëm	x	x
9	Gërmadhat e kishës së Shën Arkangjelit	Mesjetë	Bradash	x	x
10	Lokaliteti neolitik 'Gumnishtë'	Parahistori	Surkish	x	x
11	Kalaja e Ballocit	Antikitët i vonë	Balloc	x	x
B	Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore				
A	Nënkategoria: Monument/Ansambël				
1	Kisha e Shën Andrejës	shek.XIX	Qytet		x
2	Shtëpia e Kadri Metehisë	shek.XVII	Metehi		x
3	Shtëpi banimi	1935	Qytet		x
4	Kulla e Xhemail Haxhiut	shek.XIX	Herticë		x
5	Shtëpi banim- Avdullah Avdullahu	shek.XIX	Llaushë e ulët		x
6	Kishëz	shek.XIX	Rakinicë		x
7	Xhamia e Brainës	shek.XVIII	Brainë		x
8	Mulliri Metehi	shek.XX	Metehi		x
9	Pojata e Avdyl Shabani	shek.XX	Metehi		x
10	Flladniku i Avdyl Shabani	shek.XX	Metehi		x
11	Xhamia e Dumnicës	shek.XIX	Dumnicë		x
12	Kulla e Nazif Muratit	shek.XIX	Popovë		x
13	Mulliri i Demë Ahmetit	shek.XIX	Reçicë		x
14	Shtëpi banimi- Sabit Hamiti	shek.XX	Reçicë		x
15	Kulla e Demë Ahmetit	shek.XX	Reçicë		x
16	Shtëpi banimi-Musa Hamiti	shek.XIX	Reçicë		x
17	Shtëpi banimi-Hasan Ramadani	shek.XX	Shajkoc		x
18	Mulliri	shek.XIX	Majac		x
19	Koshi i Basri Rrahmanit		Lladoc		x
20	Ndërtesa e kuvendit Komunal	shek.XX	Qytet		x
21	Mulliri i lagjes Azemi	shek.XIX	Pollatë		
Të Propozuara nga Komuna					
1	Teqja në Herticë				
2	Xhamia në Herticë				
B	Nënkategoria: Fushat e konservimit arkitekturor				
1	Shishe	shek.II-IV	Vindenis,Gllamnik		x
2	Kupë	shek.II-IV	Vindenis,Gllamnik		x
3	Vazo	shek.II-IV	Vindenis,Gllamnik		x
4	Sarkofag	shek.II-IV	Vindenis,Gllamnik		x
5	Broke	shek.IV-VI	Vindenis,Gllamnik		x


6	Byzylyk	shek.IV-VI	Vindenis,Gllamnik		x
7	Broke	shek.IV-VI	Vindenis,Gllamnik		x



Figura 3. Xhamia e Brainës (fotografi nga llapi.info)

Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore janë pjesë të territorit të cilat përmbajnë karakteristikat dhe vlera të posaçme historike, artistike, trashëgimisë kulturore dhe mjedisore urbane. Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura përcaktojnë mbrojtjen afat-gjate dhe konservimin e një zonë gjeografike me karakteristika të veçanta të trashëgimisë arkitekturale dhe arkeologjike, peizazhet kulturore me potencial të zhvillimit social dhe ekonomik të vendit. Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura përfshijnë perimetrin e vend-shtrirjes së monumentit të trashëgimisë kulturore të përcaktuar për mbrojtje dhe zonës mbrojtëse të tij në radius prej 50 m (për trashëgiminë arkitekturore) dhe 100 m për trashëgiminë arkeologjike nga perimetri i monumentit. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose ngushtohet në pajtueshmëri me planin e Institucionit kompetent. Në momentin që ndonjë vlerë e trashëgimisë kulturore hyn në listën për mbrojtje të përkohshme apo të përhershme (shih në ligj procedurat për shpalljen e vlerës në

mbrojtje të përkohshme apo të përhershme), ajo regjistrohet në Kadastër (HZK Podujevë 2022 - 2030).



Harta 8. Monumentet e Trashëgimisë Kulturore në komunën e Podujevës (HZK 2022-2030)

Në hartën e lokacioneve të monumenteve të trashëgimis kulturore është paraqitur përhapja hapësinore e tyre.

2.7 Turizmi

Komuna e Podujevës si fokus të veçantë e ka zhvillimin ekonomik dhe po ashtu sektorin e turizmit si pjesë të saj. Pozita gjeografike, territori, resurset ujore, ekologjike, turistike, shëndetësore janë prioritet i komunës së Podujevës. Në bazë të analizave që janë bërë në terren dhe potencialeve turistike që zotëron Podujeva, konstatohet se zhvillimi i sektorit të turizmit do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik lokal. Duke u bazuar në prioritetet e Komunës së Podujevës por edhe rëndësinë që po i jepet kohëve të fundit turizmit, ky sektor konsiderohet me prioritet për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Komunës së Podujevës. Podujeva ka resurse turistike në secilin nivel si atë: ekoturistik, rural, malor, shëndetësor, historik, fetar, ndërkufitar, etj.. Mangësitë e identifikuar në këtë aspekt kanë të bëjnë me informimin jo adekuat, cilësinë e shërbimeve, infrastrukturën, mbeturinat, etj. Zhvillimi ekonomik i Podujevës mund të mbështetet në zhvillimin e turizmit dhe sektorëve tjerë që ndikojnë pozitivisht si transporti, komunikacioni, kurse ofertat dhe kostot janë të arsyeshme sidomos në sektorin e **hotelerisë**.



Figura 4. Kulla e Zahir Pajazitit dhe kompleksi memorial (fotografi nga telegrafi.com)

Llojet e Turizmit që zhvillohen në komunën e Podujevës sipas Strategjisë së Turizmit KK Podujevë:

- Ø Turizmi Kulturor;
- Ø Ekoturizmi;
- Ø Ekoturizmi malor;
- Ø Ekoturizmi veror dhe njëditor;
- Ø Ekoturizmi rekreativ dhe sportive,
- Ø Turizmi edukativ dhe shkencor.

Kurse Prej Atraksoneve turistike ujore janë:

- Ø Liqeni i Batllavës;
- Ø Lumi Llap;
- Ø Vrella e Revuqit;
- Ø Banja e Shakovicës;
- Ø Ujëvarat e Popovës;
- Ø Quka e Brainës;
- Ø Bellosica;
- Ø Musinca.

Prej Atraksioneve turistike historike- kulturore janë cekur në tabelën Listës së Trashëgimisë Kulturore në komunën e Podujevës në kaptinën 2.6.2 Trashëgimia Kulturore

Sipas Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit në komunën e Podujevës për të përfituar nga përdorimi i burimeve turistike, duke pasur parasysh nevojat e tregjeve kryesore të synuara, zhvillimi i turizmit mund t'i shfrytëzojë në mënyrë të balancuar potencialet e tij dhe të përqendrohet në zhvillimin e këtyre produkteve turistike deri në vitin 2021: -

- Ø Turizmi i Kulturës me të gjitha llojet e tij (Historik/arkeologjik, Trashëgimia kulturore, etj.);
- Ø Turizmi i Natyrës (Malor, Rural, Ekoturizmi, Agroturizmi, etj.);
- Ø Turizmi shëndetësor (Turizmi i ujërave termale, Turizmi mjekësor) - Turizmi i konferencave/biznesi.

Zhvillimi ekonomik i Podujevës mund të mbështetet në zhvillimin e turizmit dhe sektorëve tjerë që ndikojnë pozitivisht si transporti, komunikacioni, kurse ofertat dhe kostot janë të arsyeshme sidomos në sektorin e **hotelerisë** (SZHT Podujevë 2019-2021).





Figura 5. Liqeni I Batllavës (Fotografi nga Arian Mavriqi)

Më vonë është përdorur për ujë të pijshëm ku edhe sot furnizohet një pjesë e madhe e qyteteve të Republikës së Kosovës. Kurse viteve të fundit edhe si atraksion turistik për turistët që vizitojnë Republikën e Kosovës dhe **posaçërisht** komunën e Podujevës. Më poshtë kemi numrin e numrin e turistëve të cilët kanë vizituar Liqenin e Batllavës për periudhën 2015-2018 gjatë muajve të verës apo (Maj-Shtator) (SZHT Podujevë 2019-2021). Më 2015 rreth 130,000 turistë, 2016 rreth 130,000 turist, në vitin 2017 rreth 140,000 turist, në vitin 2018 rreth 150,000 turist.

Kompleksi i liqenit të Batllavës shquhet për bukuritë natyrore të gërshetuara nga liqeni, pyjet dhe peisazhi që e rrethon me sipërfaqe prej 220 km². Pyjet që e rrethojnë liqenin arrijnë lartësinë mbidetare, prej 800-1000 m. Liqeni i Batllavës paraqet një vend mjaft atraktiv për zhvillimin e ekoturizmit. Liqeni është i krijuar artificialisht në vitin 1959, për nevojat e Korporatës Energjetike të Kosovës për ftohjen e stabilimenteve.

3.Presionet në Mjedis

3.1 Popullsia dhe Vendbanimet



Harta 9. Vendbanimet sipas numrit të banorëve në komunën e Podujevës (burimi të dhënave ASK 2011)

Komuna e Podujevës ka shënuar rritje të konsiderueshme të popullsisë që nga viti 1948 kur kishte 43783 banor. Sipas regjistrimit të vitit 2011 kjo komunë ka 88499 banorë. Kurse sipas të dhënave preliminare të regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 kjo komunë ka rreth 71,000 banorë. Por deri këto të dhëna të bëhen publike nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ne do të analizojmë të dhënat e regjistrimit të 2011. Kjo tregon se për periudhën 1948 – 2011 popullsia

është rritur për 44716 banorë që do të thotë se për 55 vjet popullsia e Podujevës është dyfishuar. Gjatë kësaj periudhe kohore, popullsia e komunës së Podujevës ka shënuar rritje vjetore rreth 709 banor. Komuna e Podujevës ka 77 vendbanime dhe shpërndarja e popullsisë është e paraqitur në hartën më lartë. Bazuar në regjistrimin e **popullsisë** të vitit 2011, dendësia e popullsisë në komunën e Podujevës është rreth 141 banorë në 1 km², që është pak nën **mesataren** në nivel vendi prej 160 banorë në 1 km². Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël (ASK 2011). Dendësia më e lartë e popullsisë është në qytetin e Podujevës ku mesatarisht jetojnë rreth 2635 banorë në një km². Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vendbanime të tjera të cilat kanë dendësi të madhe siç janë: Letanc (660 b/km²), Obrancë (529 b/km²), Surkish (500 b/km²), Lluge (444 b/km²), Gllamnik (405 b/km²) etj. Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Rakinice (3 b/km²), Murgulle, Bllatë dhe Tërnavicë (4 b/km²), Metergoc (5 b/km²) etj, derisa Muhazobi, Përpellaci, Radujevci dhe Reçica nuk janë të populluara (DB GIS ASK 2011).

Të dhënat e shtimit natyror për vitin 2011 janë vlerësuar duke i shfrytëzuar të dhënat për lindjet dhe vdekjet nga Enti i Statistikës së Kosovës për vitin 2011 për komunën e Podujevës. Gjatë vitit 2011 në komunën e Podujevës janë shënuar 1653 lindje dhe 326 vdekje. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në promilë dhe në përqindje për komunën e Podujevës. Shkalla e natalitetit në komunën e Podujevës është 18.68 promilë, kurse shkalla e mortalitetit është 3.68 promilë. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit **del se** shtimi natyror i popullsisë në komunë është 15 promilë. Megjithatë, si rezultat i migrimit të lartë të popullsisë që komuna e Podujevës aktualisht ka, shtimi i **përgjithshëm** i popullsisë ka vlerë negative, që do të thotë se numri i popullsisë është në zvogëlim e sipër. Në bazë të vlerësimeve të popullsisë për vitin 2014 të publikuara nga Enti Statistikor i Kosovës, komuna e Podujevës ka gjithsej 86,836 banorë, që është për 1663 banorë më pak krahasuar me regjistrimin e vitit 2011. Në këtë gjendje ka ndikuar sidomos emigrimi nderkombëtarë që preku gjithë Kosovën në fundvitin 2014. Në bazë të vlerësimeve të popullsisë për vitin 2014 të publikuara nga Agjencia e Statistikave Kosovës, komuna e Podujevës ka shënuar bilans negativ të migrimit prej **gjithsej** 3318 banorë (2596 prej të cilëve të përfshirë në migrim nderkombëtarë).

3.2 Industria dhe Bizneset

Funksioni primar i zonës industriale është prodhimi industrial prandaj edhe duhet tentuar që rreth 70% të sipërfaqes së saj të përdoret për këtë qëllim, përderisa pjesa tjetër të jetë në dispozicion për aktivitete shërbyese komplementare, në funksion të prodhimit industrial. (HZK Podujevë).

Përdorimi i ujit në industri dhe amvisëri kthehet në shtratin e lumit i pa trajtuar që ka për pasojë ndërrimin e parametrave fiziko-kimik dhe biologjik të ujit.

Shkarkimi i ujërave të zeza prej amvisërisë, bizneseve dhe industrisë, jo vetëm në këtë komunë po bëhet problem serioz. Teknologjia e shtrenjtë për trajtim të ujërave të zeza ka ndikuar që edhe me këto pakë veprimtari industriale e biznese tjera të kemi probleme serioze në degradimin e natyrës e sidomos të ujërave (Pzhk Podujevë 2016-2025).

Po ashtu Zonë tjetër e cila është e planifikuar për zhvillim komercial është zona Komerciale. Zona ofron hapësirë për zhvillim të tregtisë. Për më shumë, zona do të ofrojë edhe hapësirë për zhvillime tjera të cilat janë në shërbim të **zonës** (HZK Podujevë 2022-2030).

Bazuar në shënimet e Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve, në vitin 2015 në Podujevë janë të regjistruara gjithsej 740 ndërmarrje industriale me 2318 punëtorë, që paraqet 19% të numrit të përgjithshëm të bizneseve të regjistruara dhe mbi 30% të të punësuarve. Kjo tregon se sektori industrial krijon numër të madh të vendeve të punës dhe duhet t'i kushtohet **rendësi** e **veçantë**. Numrin më të madh të bizneseve industriale e përbejnë bizneset në sektorin e industrisë përpunuese me mbi 50% të bizneseve dhe mbi 54% të të **punësuarve** të sektorit të industrisë.

Komuna e Podujevës është e pasur me resurse të shumta minerare dhe prej tyre më të njohura janë mineralet që përdoren në industrinë e ndërtimit si: Silikatet (sh), Karbonatet (ch), Graveli (gs), Kley (cl), pastaj, Nikeli (NI), Plumbi (Pb), Zinku (Zn) dhe Alumini (Al) (KPMH Harta e Mineraleve).

Nga të gjitha bizneset që janë aktive në komunën e Podujevës, tregtia zë vendin kryesor me rreth 45% të pjesëmarrjes në biznese dhe mbi 36% të të **punësuarve** në biznese. Numri më i madh i **ndërmarrjeve** tregtare dhe numri i të punësuarve në tregti i përkasin tregtisë me pakicë me mbi 66% të pjesëmarrjes së **ndërmarrjeve** tregtare dhe mbi 57% të të punësuarve në sektorin e tregtisë.

Bazuar në të dhënat e Pzhk-së Veprimtaritë e eksploatimit minerarë ushtrohen edhe nga 7 operator ilegal të cilët veprimtaritë e tyre i kanë të lokalizuara kryesisht në këto vendbanime, si; Repe, Podujevë, Majac, Llužhan, Turiqec dhe Batllavë (2). Këta operator duhet që ti nënshtrohen

legalizimit ose të mbyllët veprimtaria e tyre, por gjithsesi menaxhimi dhe monitorimi i këtyre aktiviteteve në komunën e Podujevës është çështje së cilës duhet kushtuar vëmendje e veçantë (Pzhk Podujevë 2016-2025).

3.3 Infrastruktura

Pozita gjeografike e komunës së Podujevës në të cilën kalojnë rrugë të rëndësishme nacionale, i mundësojnë komunikim të mirë dhe mjaft efikas, ku në nivel të komunës administrative janë të shtrira gjithsejtë 1225km rrugë të të gjitha kategorive. Nëse analizohet niveli i mbulshmërisë së sipërfaqes së komunës me rrugë të të gjitha kategorive **del se** ato janë të shtrira në gjithsejtë 497.7ha.

3.3.1 Transporti

Nga të dhënat të pasqyruara në Hartën Zonale Komune të Podujevës mbetet transporti rrugor është një nga burimet më të mëdha të ndotjes, duke kontribuar në cilësi të dobët të ajrit, zhurmës dhe ndryshimet klimatike. Transporti i mallrave dhe udhëtarëve bëhet me mjete të ndryshme të cilat janë të prirura të ndotin mjedisin duke ndikuar në ndotje të ajrit nga transporti. Ndotësit e ajrit nga transporti përfshijnë oksidin e azotit, grimcat, monoksidin e karbonit dhe hidrokarbure. Të gjithë kanë një ndikim të dëmshëm në shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimësisë në nivel lokal. Për të lehtësuar gjendjen mjedisore parashihet të realizohet projekti i rrugës transit, i cili e redukton ndotjen nga komunikacioni. Si përparësi Brenda zonës urbane është edhe ndërtimi i rrugës së qendrës, që është me dy korsi, ku lëvizja e automjeteve dhe transportit është dukshëm me i lehtë duke krahasuar me gjendjen e viteve të mëparshme.

3.3.2 Transporti Rrugor

Bazuar në të dhënat e Hartës Zonale Komunale transporti rrugor në komunën e **Podujevës** ndahen në

- Ø Rruga nacionale N25: Sipas PZHK-së është paraparë zgjerimi i saj me 4 korsi në segmentin nga rreth-rrrotullimi ku përfundon Autostrada Ibrahim Rugova deri tek Hotel Besiana në një gjatësi prej 20km, rritja e cilësisë së asfaltit nga kufiri me komunën e Prishtinës deri tek vendbanimi Merdar me gjatësi 18.8km, mirëmbajtja e rrugës, rregullimin e anësoreve, trotuareve, sinjalizimit, kufizimin e aktiviteteve ekonomike përgjatë segmenteve rrugore sipas **standardeve** etj.

- Ø Rrugët rajonale, sipas PZHK-së kanë nevojë për mirëmbajtjen e rregullt, rregullimin e trotuareve, zgjerimin e rrjetit rrugor, rregullimin e anësoreve, sinjalizimin, kufizimin e aktiviteteve ekonomike etj.
- Ø Rrugët lokale: PZHK rekomandon rregullimin e rrugës tranzit në gjatësi 2.45 km e cila do të lidh Rrugët R126 dhe R127; mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara dhe atyre me mbulesë nga rëra dhe zhavorri, të cilat kryesisht shtrihen në tërësitë Malet dhe **Peizazhet** e Natyra dhe Turizmi; rregullimin e trotuareve, sinjalizimit, anësorëve si dhe aty ku është e nevojshme apo mungon shtrirjen e shtigjeve për transport jo të motorizuar përfshirë dhe shiritat e gjelbër. Duke pas parasysh që HZK planifikon plotësimin, dendësimin dhe konsolidimin e vendbanimeve kërkohet ndërtimi i rrugëve të reja lokale apo asfaltimi i rrugëve lokale (kryesore, përmbledhëse dhe rrugëve për qasje) ekzistuese brenda vendbanimeve rurale. Rrugët e pa kategorizuara shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera si në brendësi të vendbanimeve, po ashtu edhe në sipërfaqet e tjera të vendbanimeve. Kjo kategori e rrugëve nuk është e asfaltuar, mirëpo rrugët të cilat shfrytëzohen për lidhjen hapësirave në brendësi të vendbanimeve, si dhe ato të cilat i lidhin vendbanimeve në thellësi të komunës, përkatësisht të viseve malore janë të shtruara me rërë dhe zhavorr. Ndërsa rrugët e tjera të kësaj kategorie janë rrugë të cilat shfrytëzohen për aktivitete bujqësore.

Urat- Bazuar në të dhënat e HZK-së në komunën e Podujevës gjithsej janë 102 ura që i përkasin kategorisë së komunikacionit rrugor dhe hekurudhor. PZHK rekomandon rehabilitimin dhe zgjerimin e disa urave, që të jenë më stabile dhe më të sigurta për qarkullim edhe gjatë rritjes së nivelit të ujit në liqenin e Batllavës. Raporti për vlerësimin e zbatimit të PZHK-së, tregon që ka pasur investime në rregullimin dhe zgjerimin e urave. Këto investime bëhen në baza të rregullta vjetore meqenëse komuna ka një numër të madh të lumenjve (*Hzk Podujevë 2022 ó 2030*).

3.3.3 Transporti hekurudhor

Me PZHK është paraparë rregullimi i sinjalizimit për vijën hekurudhore, në vendbanime të mëdha dhe të frekuentuara me dendësi të popullsisë e sidomos në qendrat (Podujevë, Surkish, Siboc i Epërm, Lluzhan). Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK-së, ky veprim nuk është realizuar. Në bazë të dhënave nga INFRAKOS, planifikohet të vihet në funksion segmentit të rrjetit hekurudhor që kalon nëpër komunën e Podujevës, ku matjet gjeodezike kanë përfunduar, matjet

gjeomekanike dhe projekti janë në proces. Me projektin e ri traseja e linjës do të mbetet e njëjta dhe do të shqyrtohen të gjitha 29 vendkalimet **ekzistuese** për mundësinë e vazhdimit të statusit vendkalim, eliminim të disa prej tyre, por dhe nëse është e nevojshme hapje të ndonjë vendkalimit (disnivele) të ri. Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plani i veprimit 5 vjeçar i Ministrisë së Infrastrukturës, ka përcaktuar rindërtimin e linjës hekurudhore në drejtimet Podujevë-Prishtinë-Fushë Kosovë Pejë si mundësi për të krijuar një linjë/degë, e cila i shërben aeroportit të Kosovës dhe organizimin e lidhjeve të mira përmes të cilave ofrohen shërbime të qëndrueshme për popullsinë. Ky projekt kap një shumë prej 290 000 000 eurosh. Strategjia promovon intermodalitetin autobus-hekurudhë për udhëtime të pasagjerëve si objektiv afatmesëm/afatgjatë, që do të financohej me mjetet e planifikuara për përmirësimin e rrjetit hekurudhor dhe ngritjen e nivelit të shërbimeve për udhëtarë. Infrastruktura ekzistuese hekurudhore edhe pse në gjendje jo të mirë, paraqet bazë të mirë për modernizimin e saj, e me këtë edhe për ofrimin e shërbimeve cilësore për transportin e udhëtarëve, në kombinim me linjat e autobusëve. Duke u nisur nga kjo, me HZK është propozuar hartimi i studimit të fizibilitetit për ndërtimin e Qendrës multimodale të transportit e cila do të përfshinte stacionin hekurudhor, të autobusëve, rrugën tranzit në afërsi të qendrës komunale për shmangien e kalimit të automjeteve brenda saj, parkingjet, taxit, etj. Propozimi i INFRAKOS për sipërfaqen e tokës në pronësi të tyre përballë stacionit hekurudhor është që të ndërtohet një stacion i autobusëve, vend-parkingjet për biçikleta, taksi dhe eventualisht edhe ndonjë shërbim tjetër transportues. Planet për shfrytëzim të patundshmërisë janë komerciale respektivisht dhënie me qera pas marrjes së pëlqimit për ushtrim të veprimtarisë nga Komuna. Studimi i fizibilitetit duhet të identifikojë ndikimin në transport dhe në shfrytëzimin e tokës, vlerësimin e kostove dhe përfitimeve dhe vlerësimin ‘vlerës në para’. Studimi duhet të merr parasysh të dhëna të sakta të udhëtimeve në linjat ekzistuese ndër-urbane dhe parashikimet për numrin e shfrytëzuesve të ardhshëm. Strategjia po ashtu parasheh Sigurimin e vendkalimeve në hekurudha përmes instalimit të sinjalizimit horizontal dhe vertikal, eliminimin e ndërtimeve ilegale në brezin mbrojtës të hekurudhave.

3.3.4 Sipërfaqet e rrjetit të transportit- ajror

Në bazë të HZK në komunën e Podujevë ekziston aeroporti sportiv në Dumosh. Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 e Ministrisë së Infrastrukturës, ka përcaktuar

Renovimin e tij (renovimin e ndërtesave ekzistuese, rregullimin e pistës, vendosjen e një hangari të parapërgatitur, rregullimin e rrethojës) (*Hzk Podujevë 2022 ó 2030*).

3.3.5 Ndriçimi Publik

Në bazë të PZHK-së Ndriçimi Publik – është evident në zonën urbane të komunës dhe ka gjatësi prej 4150 metra³². Rrjeti i sistemit të ndriçimit është i përbërë prej 153 shtyllave, prej tyre metalike 80 ndërsa shtylla të drurit 73. Rrjeti është i shpërndarë në rrugën “Zahir Pajaziti” me 35 shtylla të metalta me lartësi (H=8.5 m) dhe me gjatësi 500 metra, rruga e “28 Nëntorit me 15 shtylla të metalta me lartësi (H=8.5 m) dhe me gjatësi 450 metra, rruga “Hakif Zejnullahu” me 30 shtylla të drurit me gjatësi 900 metra, rruga “Skenderbeu” me 30 shtylla të metalta me ndriçim me lartësi (H=9 m) dhe gjatësi 1000 metra , pjesa tjetër e rrugës “Skenderbeu” me 30 shtylla të drurit me lartësi (H=9 m) dhe gjatësi 1000 metra. dhe rruga “Abdyl Lahu me 13 shtylla të drurit me lartësi (H=9 m) dhe gjatësi 300 metra. Kurse kohëve të fundit kemi shtrirje edhe në disa prej zonave rurale të qytetit (*Pzhk Podujevë 2016-2025*).

3.3.6 Shërbimet e telekomunikacionit

Rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Podujevës është i lidhur nëpërmjet fibrës optike, i cili i përket linjës së trasesë Prishtinë–Podujevë. Ky rrjet menaxhohet nga njësia e PTK-së në Podujevë e cila ka vetëm një objekt postar dhe ka centralin e lidhur me fibër optik. Kapaciteti total i centralit të postës në Podujevës është gjithsej 7200 qifte 38, prej të cilave 1771 shfrytëzohen, ndërsa pjesa tjetër është e pa shfrytëzuar.

Operatorët me ndikim më të madh në komunën e Podujevës:

- Ø PTK - Darda NET, nëpërmjet të telefonisë fikse;
- Ø IPKO – ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave individuale Së fundmi edhe me kablo dhe
- Ø KUJTESA - ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave individuale Së fundmi edhe me kabllor.

Radiotelevizioni lokal në komunën e Podujevës është RTV Llapi (*Pzhk Podujevë 2016-2025*).

3.3.7 Ujësjellësi dhe Kanalizimi

Sipas raporti të MAPL për performancën e komunave, Komuna e Podujevës rangohet në mesin e komunave me shtrirje mesatarisht të ulët të ujësjellësit që përfshin 66.58% të vendbanimeve në atë komunë. Në krahasim me komunat tjera, Komuna e Podujevës është një ndër komunat me shtrirje mesatarisht të lartë të rrjetit të kanalizimit (*Instituti GAP 2020*).

Kurse sa i për ketë Furnizimit me ujë të pijshëm të **popullatës** në komunën e Podujevës e bënë KRU Prishtina. Sistemi i kanalizimit është i shtrirë në pjesën urbane të komunës dhe disa pjesë rurale kurse te disa vendbanime të thella malore nuk kemi sistem të kanalizimit.

Sot komuna e Podujevës furnizohet me ujë nga dy drejtime:

- Ø Nga fabrika e ujit në Shajkofc
- Ø Nga sistemet e pompimit nga puset e Peranit Nga viti 1983 komuna e Podujevës furnizohet me ujë të pijshëm nga fabrika e përpunimit të ujit në Shajkofc-Albanik, ku prej deponisë qendrore të ujit të pijshëm, uji distribuohet në drejtim të deponisë së ujit të pijshëm në Podujevë përmes tubacionit magjstral me gjatësi 8.22 km, me diametër DN 300 mm, nga materiali daktil dhe me kapacitet $Q=130$ l/sec.33 Në këtë tubacion magjstral janë të kyqur nëntë vendbanime me gjithsej 16136 banorë ose 18.2 % të popullatës së komunës (*Pzhk Podujevë 2016-2025*).

3.3.8 Rrjeti Elektrik


Në rrjetën e furnizimit me energji elektrike të komunës sipas drejtimeve të shpërndarjes së shfrytëzuesve, janë të vendosura gjithsej 237 trafo-stacione të kapaciteteve të ndryshme. Duke u nisur nga ky fakt mund të konstatojmë se nga 237 TS funksionale, 23 prej tyre janë individuale, ndërsa 214 të tjera janë kolektive. Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të energjisë (bazuar në orë regjistruese) është 14452 shfrytëzues, të cilat e furnizojnë komplet territorin e komunës me energji elektrike. Shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike mund të konstatojmë se 100% e popullsisë së komunës kanë qasje në rrjetin energjetik të Kosovës.

Pozita gjeografike e komunës i mundëson një rrjet të rëndësishëm të furnizimit me energji elektrike. Përveç linjave të furnizimit me energji elektrike me kapacitet 35kv, të cilat vijnë nga drejtimi i Prishtinës (Obiliq – Mazgit – Koliq – Besianë), në territorin e komunës kalojnë edhe linjat transite të tensionit të lartë Internacional (Prishtine – Besian – Krushevc 220KV) dhe

Obiliq (Kosova B – Nish me kapacitet 400KV). Furnizimi i qytetarëve të Podujevës me energji elektrike bëhet nëpërmjet të linjës së Prishtinës me kapacitet prej 220KV (Kosova B – Besianë) deri tek trafo-stacionit kryesor, i cili gjendet në komunën kadastrale të Podujevës dhe ka gjatësi prej 30.67 km dhe linja Mazgit – Podujeve 35KV me gjatësi prej 25.88 km (*Pzhk Podujevë 2016-2025*).


Tabela 7. Trafostacionet në komunën e Podujevës

Nr.	Emri I Daljes	Nr-TS	Individuale	Kolektive	Nr. Konsumatorëve	%
1	Batlavë	19	1	18	933	6.45
2	Batlavë - Orlan	18	1	17	487	3.4
3	Podujevë 1	12	1	11	1460	10.1
4	Podujevë 2	7	0	7	1055	7.3
5	Podujevë 3	4	0	4	992	6.86
6	Podujevë 4	6	1	5	788	5.45
7	Podujevë 5	6	1	5	788	5.45
8	Sillosi	7	1	6	756	5.23
9	Ballovcit	29	4	25	1437	9.94
10	Fshatrat 1	28	3	25	1222	8.46
11	Fshatrat 2	29	3	26	1050	7.27
12	Livadica	14	1	13	674	4.66
13	Letanci	31	4	27	1575	10.89
14	Llausha	27	2	25	1235	8.54
	Totali	237	23	214	14452	100



Grafikoni 2. Numri i Konsumatorëve sipas daljeve të trafostacioneve

3.4 Bujqësia



Harta 10. Zonat Bujqësore në komunën e Podujevës

Me hyrjen në fuqi të Hartës Zonale Komunale ruajtja e tokës bujqësore është prioriteti kryesorë. Toka bujqësore është toka e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave bujqësore si arë, fidanishte, pemishte, vreshta, livadhe, kullota, hurdha peshku dhe moçale, si dhe tokat tjera që nuk janë në shfrytëzim për qëllime bujqësore, por që shfrytëzimi optimal i të cilave përfshinë prodhimin bujqësor, duke marrë parasysh vetitë e tyre natyrore dhe kushtet ekonomike (UA mbi Normat Teknike të Planifikimit hapësinor) Sipas PZHK-së (PZHK komuna e Podujevës 2016- 2026),

sipërfaqja bujqësore shtrihet në të tri tërësitë hapësinore të Podujevës që përfshijnë gjithsej 62.870ha ku 25% e sipërfaqes i përket klasës I-IV, dhe pjesa e mbetur klasës V–VII. Në këto sipërfaqe është rekomanduar të zhvillohen bujqësia dhe blegtoria. Për periudhën dy-vjeçare, vlerësimi i zbatimit të planit ka vënë në pah progresin në zbatimin e një mori veprimeve të parapara në fushën e zhvillimit të bujqësisë të cilat përfshijnë veprimet të cilat kanë ndikuar në shtimin e numrit të bizneseve në këto lëmi duke mundësuar rritjen e numrit të fermerëve, bletarëve dhe blegtorëve rrjedhimisht rritjen e sipërfaqeve të punueshme dhe produktivitetit. Bazuar në këto zhvillimi edhe HZK e konsideron prioritet zhvillimin e këtyre dy fushave.

Bujqësia tash për tash nuk është ndonjë ndotës i madh në Komunën e Podujevës. Shumica e helmeve që përdoren janë helme kundër barojave të këqija, në sasi të vogël përdoren edhe insekticide për zhdukjen e insekteve të dëmshme.


Komuna e Podujevës është komunë kryesisht rurale pasi që mbi 70% e popullsisë jetojnë në zonat rurale. Komuna e Podujevës ka resurse të konsiderueshme që mundësojnë zhvillimin e bujqësisë. Komuna e Podujevës ka fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore. Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) 2011 – 2014 në Komunën e Podujevës janë gjithsej 33,295 hektarë tokë bujqësore.

Rreth 56% apo 18562 hektarë është tokë e punueshme që përdoret për lavërtari. Kullosat përbejnë 16% të tokës bujqësore (5186 hektarë) dhe pjesa tjetër përdoret për perimtari, pemëtari, vreshtari etj.

Tabela 8. Kultivimi i Kulturave lavërtare dhe prodhimtaria **Tabela 9. Prodhimtaria e Perimeve**

Kultura	Sipërfaqja ha	Prodhimtaria (kg/ha)
Grurë	4380	5000
Elb	22	3500
Thekër	122	3000
Misër	2928	6500
Tërshërë	1485	3500
Patate	1936	50000
Sanë	3200	6000
Jonxhë	2800	6500

Perimi	Prodhim (tona /
Speci	25-30
Domatja	40-50
Lakra	50-55
Karrota	20
Qepa	25-30
Sallata	15
Spinaqi	15
Tranguilli	30
Purrini	30
Lule Lakra	40
Hudhra	8



Grafikoni 3. Prodhimtaria sipas kulturave bujqësore kg/ha

Tabela 10. Prodhimtaria e Pemëve

Pema	Sipërfaqja ha	Prodhimtaria (kg/ha)
Molla	6	8000 - 10000
Dardha	4	10000
Kumbulla	25	9000
Dredhëza	2	3000
Mjedra	4	6000 - 7000

Tabela 11. Statistika - mbajtja e kafshëve

Kafsha	Nr. I Fermave	Numri I Krerëve
Lopë	374	3740
Dele	70	4500
Dhi	10	520

Tabela 11. Statistika - mbajtja e kafshëve

Komuna e Podujevës ofron mundësi të mira për zhvillimin e blegtorisë. Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) 2011 – 2014 në komunën e Podujevës, në gjithsej 454 ferma janë 8760 krerë shtazë. Edhe pse kjo paraqet një numër të konsiderueshëm, gjendja në këtë degë bujqësore mund të jetë më e mirë duke marrë parasysh kushtet e favorshme që ekzistojnë. Gjithashtu pylltaria është pjesë e veprimtarive primare, prandaj ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe në veçanti në zhvillimin e bujqësisë. Komuna e Podujevës ka një fond të konsiderueshëm të pyjeve. Bazuar Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) 2011 – 2014, 29,050 hektarë të territorit të komunës është e mbuluar me pyje (Pzhk Podujevë 2016-2025).

Në komunën e Podujevës Drejtoriati për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural funksionon përmes dy sektorëve:

Ø Sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimi Rural;

Ø Sektor i Pylltarisë

Qëllimet kryesore të politikave bujqësore:

- Ø Kalimi nga prodhimtaria në ferma që plotësojnë **nevojat** e ekonomisë familjare në ferma gjysmë komerciale dhe komerciale;
- Ø Zbutja e **papunësisë**, **varfërisë** dhe **përmirësimi** i cilësisë së jetës për banorët e zonave rurale;
- Ø Objektivat e **përgjithshme** të DBPZHR;
- Ø Edukimi **i** vazhdueshëm dhe përcjellja e inovacioneve në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural e **po ashtu** edhe në sektorin e pylltarisë;
- Ø Forcimi i zingjirit ushqimor, mbrojtja e kafshëve dhe menaxhimi i rrezikut në bujqësi;
- Ø Përfshirja sociale, zvogëlimi i varfërisë dhe zhvillimi ekonomik në viset rurale;
- Ø Mbështetja në **riaktivizimin** e fermave, plantacioneve bujqësore si dhe kapaciteteve ushqimore në komunën e Podujevës.

Kurse **f**okusi kryesor **janë** fushat si:

- Ø Pemëtaria – pemët e imëta (mjedra, dredhëza, manaferra, boronica dhe aronia)
- Ø Perimtaria
- Ø Blegtoria
- Ø Bletaria

DBPZHR në vitin 2023 në **kuadër** të zhvillimit bujqësor të komunës ka bërë **përkrahjen** e **fermerëve** në shumë aktere si : përkrahja e fermerëve me fidane të mjedrës, feferona, furnizimi dhe montimi **i** serrave për fermerë, furnizimi me mekanizëm bujqësor, furnizimi me mësherra, furnizimi me mekanizëm bujqësor për familjet me kushte të rënda ekonomike, përmirësimi I punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të **Kosovës** nga marrëveshja e bashkëpunimit ne mesë KK Podujevës dhe IADK- Iniciativa për **Zhvillimin e Bujqësisë** së Kosovës, **përkrahja** e **fermerëve** me **mëshqerra**, **mbjellja** e drunjëve dekorativ etj.

Kurse në kuadër të sektorit të pylltarisë si pikë kyqe ka qenë që të **zvogëlohet** sa më shumë:

- Ø Prerja Ilegale Pyjeve
- Ø Sëmundjet e ndryshme dhe
- Ø Të evidentohen dhe pengohen zjarret pyjore, kullosat ilegale, deponitë e mbeturinave, nxjerrja e gurëve, zhavorr, dheut etj. (DBPZHR 2023)

4. Gjendja e Mjedisit

4.1 Resurset Ujore dhe Menaxhimi I tyre

Bazuar në të dhënat e shkruara më lartë komuna e Podujevës është relativisht mirë e pasur me ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore, në komunë gjendet BD Akumulimi i "Batllavës", si zonë e mbrojtur më datë 24.04.2013 sipas vendimit 17/127. Kurse si lumë kryesor lumi Llap bëhet monitorimi nga IHMK që nga burimi i tij mbi fshatin Marincë dhe vazhdon pastaj stacioni i dytë në Podujevë në dalje të qytetit dhe stacioni i tretë dhe i fundit në Lumadh para puçitjes së tij me lumin Sitnicë dhe nuk ka tejkalim të vlerës mesatare lumore (AMMK 2020).



Figura 6. Liqeni i Batllavës pamje me dron (fotografi nga gazeta Bota Sot)

Sa i për ketë Furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës në komunën e Podujevës e bënë KRU Prishtina (AMMK 2020).

Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK i bërë në vitin 2018, gjatë dy viteve të zbatimit të PZHK ka pasur realizim të pjesshëm të projekteve për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Orllan dhe punohet në vazhdimësi në zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit. Rrjeti i “Vrella e Revuqit” ku janë përfshirë gjashtë fshatra është kryer pjesërisht, kaptazha dhe rezervuari nuk janë kryer. Projekti është ndërprerë. Sipas të dhënave nga Kompania Regjionale e Ujësjellësit “KRU Prishtina”- NJOU në Podujevë, ka probleme në furnizimin e vendbanimeve me ujë nga

burimi i Revuqit për shkak të pamundësisë së qasjes nga banorët e pronave përreth si dhe kapacitetit të ulët i cili verës bie deri në 7l/sec përderisa prurja maksimale është 35[l/sec] gjatë muajit Prill. Prandaj HZK propozon që të bëhet analiza dhe punimi i elaboratit për gjetjen e modaliteteve për shtimin e kapacitetit (qoftë në formë të burimeve shtesë apo tjetër) për plotësimin e nevojave të vendbanimit. Për Kaptimin e burimit “Vrella e Zhitisë” duhet të bëhet punimi i elaboratit hidrogeologjik. KUR “Prishtina” ka informacion që potencial për furnizimin e banorëve me ujë është edhe një burim në fshatin Surkish dhe Sfeqël, përgjatë lumit Dumnice si dhe në Murgull dhe Llapashticë. HZK ka lokalizuar këto burime dhe përcakton punimin e studimit të fizibilitetit dhe më pas të elaboratit hidrogeologjik.

Normat e furnizimit të vendbanimeve, me sasinë e nevojshme ditore të ujit janë si në vijim:

1. Ujë për shfrytëzim për nevojat konsumuese/ ujë për pije dhe amvisëri:
 - Ø për vendbanime $\geq 5001-20000$ banor: $\geq 150-200$ litra/banor;
 - Ø për vendbanime < 5000 banor: $\geq 100-150$ litra /banor.
2. Ujë për shfrytëzim për nevojat jo-konsumuese-rekreacion/ ujë për mirëmbajtje të hapësirave publike (Sipërfaqet e gjelbra, rrugët dhe sheshet): 1.50 litër/m². Duke ju referuar strategjisë së ujërave 2017-2036, kudo që është e përshtatshme dhe e aplikueshme, të aplikohen sistemet e qëndrueshme urbane të drenazhimit në veçanti në zonat e reja zhvillimore dhe gjatë renovimit të sistemeve ekzistuese të rrjetit (*Hzk Podujevë 2022 -2030*).

4.1.2 Menaxhimi Ujërave të ndotura

Ujërat e zeza përmbajnë shumë lëndë që shpenzojnë oksigjenin e tretur, komponime të tretshme të fosforit dhe azotit, bakteve dhe viruse patogjene, metale të rënda: Cd, Hg, Zn, Pb, Cr etj., si dhe materie të tjera që prishin cilësinë e ujit. Lumenjtë janë pjesa më e atakuar nga ndotja, ngase dominon logjika se lumi me masën e vet ujore bartë dhe largon gjithçka. Përveç ndotjes kimike të ujërave, është edhe ndotja fizike nga mbeturinat që nuk treten dhe përhapen në shtratin e lumit, e disa transportohen. Mbeturinat e ngurta që janë organike ndikojnë në ndotjen biologjike, që pas dekompozimit të tyre krijohen kushte të përshtatshme për jetesën e mikroorganizmave të ndryshëm, si dhe parazitëve që janë të dëmshëm për shëndetin e njeriut, florën dhe faunën që jeton në lumenj. Të gjitha këto lloje të ndotjeve i zvogëlojnë kushtet jetike për botën e gjallë që jeton në këto ujëra (*Pzhk Podujevë 2016 - 2025*).

Pjesa më e madhe e ujërave të zeza të kanalizimeve derdhen pa asnjë trajtim paraprak në shtratin e lumit “Llap” në lokacionin te lagja Polonicë, që ndodhet në jug të qytetit. Sistemi i kanalizimit të ujërave fekale tani është në menaxhim të njësisë operative të ujësjellësit dhe ofron shërbime në qytetin e Podujevës me lagjet përreth dhe në fshatrat të cilat posedojnë rrjetin e ujësjellësit. Në bazë të dhënave komunale si dhe vrojtimeve në terren, disa sektorë të shtretër të lumenjve janë kthyer në deponi hedhurinash, si ato te amvisërisë, mbeturina tjera urbane dhe rurale, pastaj shkarkimi i ujërave të zeza të vendbanimeve dhe industrisë si dhe nxjerrja e inerteve ka degradua ujin e lumenjëve.

Hedhja e mbeturinave janë prezent në të gjithë lumenjtë e Komunës së Podujevës. Janë identifikuar këto pika degraduese në shtretërit e lumenjve: Repë, Bajçinë, Peran, Obranqë, Podujevë, Sibofc i Epërm, Sallabajë, Lupç i Poshtëm. Këto janë pikat më të degraduara të shtratit të lumit Llap.

4.2 Ajri dhe Zhurma

4.2.1 Cilësia e Ajrit

Njëri ndër problemet kryesore që paraqitet si pasojë e ndotjes nga transporti është emisioni i lartë i gazrave nga lëndët djegëse të automjeteve si: CO₂, NO_x, SO₂, CO₂. Emisionet nga automjetet shkaktojnë pjesën më të madhe të ndotjes me metalet e rënda si: Pb, etj. Koncentrimi më i madh i kësaj ndotje nga qarkullimi i automjeteve është përgjatë rrugës kryesore Prishtinë-Podujevë – Merdare (*Pzhk Podujevë 2016-2025*).

Gjithashtu siç u cek më lartë që transporti mbetet si faktori kryesor për ndotjen e ajrit në komunën e Podujevës, o ashtu edhe industria, pluhurat që shkaktohen si pasojë e aktivitetit ndërtimore dhe punët tjera që krijojnë pluhur. Dihet që Stacione matëse nuk ka në këtë regjion, prandaj mungesa e të dhënave ka ndikuar në një përshkrim të gjendjes të tillë. Në hapësirat ku objekte banimi janë shtëpitë individuale dhe ngrohja është individuale, emetimi i tymit është i lartë dhe në sezonin e dimrit kur shoqërohet me mjegull është tejet i rrezikshëm, ngase në situata të tilla nuk ka erë që do ta shpërndante. (*Plvm Podujevë 2017-2022*).

Po ashtu komuna e Podujevës ende nuk ka Plan Lokal për cilësi të Ajrit prandaj te kjo pjesë mbetet që në të ardhmen të zhvillohen shumë projekte të cilat janë në dobi të shëndetit të njerëzve. Sipas Ligjit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, masat të cilat ndërmerren me qëllim të mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe shtresës së ozonit, nuk duhet të dëmtojnë

përbërësit tjerë të mjedisit, cilësinë e jetës së brezave të sotëm dhe të ardhshëm dhe nuk duhet të jenë në kundërshtim me rregullat nga fusha e mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut. Masat për përmirësimin e cilësisë së ajrit duhet të jenë në harmoni me objektivat afatgjate të BE të përshkruara në Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, Ekonominë Qarkore e koncepte tjera, të cilat sigurojnë rritjen ekonomike, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit

4.2.2 Zhurma

Bazuar në çka u tha më lartë shkaktarët kryesor të zhurmës në komunën e Podujevës janë lëvizja e automjeteve, industria, aktivitetet e punës etj. Sipas Ligjit për mbrojtjen nga zhurma – burim i zhurmës është çdo vibracion i detektueshëm nga veshi i njeriut, i shkaktuar nga ndonjë mjet apo aktivitet i njeriut. Në kuptim ligji për mbrojtje nga zhurma, dita zgjat 12 orë dhe fillon nga ora 07:00 deri në 19:00, mbrëmja zgjat 3 orë dhe fillon nga ora 19:00 deri në ora 22:00, kurse nata zgjat 9 orë dhe fillon nga ora 22:00 deri në ora 07:00 në mëngjes. Komuna e Podujevës nuk ka Plan të veprimit kundër zhurmës e po ashtu as hartën strategjike të zhurmës të cilat do të kishin ndihmuar në zhvillimin e projekteve të nevojshme. Kurse Harta Zonale Komunale qartë i ka të specifikuar zhvillimin e aktiviteteve të lejuara në harmoni kundër ndotjes nga zhurma. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vlerat kufitare të burimit të zhurmës.

Tabela 12. Vlerat Kufitare të burimit të zhurmës varësisht sipas llojit të trafikut.

Vlerat Kufitare të burimit të zhurmës (dba)	Trafiku Rrugor		Trafiku hekurudhor	
	Ditën Ld	Natën Ln	Ditën Ld	Natën Ln
Zonat industriale	69	59	68	58
Zonat rurale	64	54	65	53
Zonat mikse	64	54	65	53
Zonat e banimit dhe vendbanimet e vogla	59	49	57	48
Institucionet publike dhe sociale	57	47	54	45

Po ashtu edhe në rregulloren për mbrojtjen e Mjedisit në komunën e Podujevës janë specifikuar aktivitetet dhe nivelet e zhurmës që nuk duhet tejkaluar dhe gjobat për personat fizik dhe juridik.

4.3 Menaxhimi I Mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën Podujevë kryhet nga dy Kompani:

- ◁ „Kompania Regjionale e Mbeturinave „Pastrimi”, sh.a. është krijuar nga ndërmarrjet komunale të komunave në regjionin e Prishtinës, në vitin 2006. Në kuadër të komunës vepron Njësia operative KRM „Pastrimi”.
- ◁ Kompania Private “Natyra“ sh.p.k. e cila ka filluar punën nga marsi i viti 2015, dhe ka lidhur kontratë me amvisëritë dhe bizneset.

Në tabelën e mëposhtme jepet qartë numri i amvisërive dhe institucioneve të cilat shërbehen nga dy kompanitë në komunën e Podujevës (*PLMMK Podujevë 2017-2022*).

Sipas të dhënave të mundësuar nga kompania KRM “Pastrimi“, e cila ofron shërbimin në Komunë, mesatarisht në të gjithë territorin ku ushtron aktivitetin, grumbullohen rreth 22ton/ditë mbeturina, 400-440 ton mbeturina/muaj.

Tabela 13. Amvisëritë dhe institucionet të cilat shërbehen me dy kompanitë e menaxhimit të mbeturinave

Nr	Pastrimi Sh.A	Natyra sh.p.k	Gjithsej
Amvisëritë	4553	2301	6854
Institucionet private komerciale dhe industrinë e shërbyera	721	52	773
Institucionet qeveritare dhe ato publike	42	13	55

Deri tani nuk është kryer ndonjë hulumtim në Komunën Podujevë në lidhje me përbërjen mercollogjike të mbeturinave. Në vitin 2011 GIZ në Kosovë ka kryer studim për përbërjen e fraksioneve të mbeturinave dhe në nivel kombëtar mbeturinat organike përbëjnë 43% të rrymës së mbeturinave. Ndërsa fraksione të tjera të mbeturinave si lënda drusore, letra, plastika, qelqi, metalet, materialet e përbëra, tekstilet, mbeturinat tjera, si dhe kategori të tjera të papërcaktuara përbëjnë rreth 37% të rrymës së mbeturinave. Pjesa tjetër e fraksioneve të rrymës së mbeturinave janë fraksione të parikuperueshme (*PLMMK 2017-2022*).

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur përqindja e mbulueshmërisë të njësive me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave:

Tabela 14. Përqindja e mbulimit të njësive në Komunë me shërbim

Kategoritë	Njësitë
Nuk Ofrohet Shërbim	Brainë, Brecë, Dvorishtë, Hërticë, Kalaticë, Kushevicë, Lupç i Epërm, Metergoc, Miroc, Muhazob, Murgull, Përpellac, Popovë, Potok, Radujevë, Rakinicë, Reçicë, Sllatinë, Surdull, Sylevicë, Tërnavicë, Turuçicë
<10% e amvisërive me shërbim	Batllavë, Dyz, Pakashticë e Epërme, Revuç
11% - 30% e amvisërive me shërbim,	Dobratin, Dumnicë e Poshtme, Livadicë, Metehi, Obrançë, Pakashticë e Poshtme, Pollatë, Siboc i Epërm, Orllan
31% - 50% e amvisërive me shërbim	Bajçinë, Ballofcë, Bellopojë, Bradash, Dobërdol, Dumosh, Gërdoc, Gllamnik, Halabak, Kaçybeg, Kërprimëh, Llapashticë e Epërme, Llapashticë e Poshtme, Llaushë, Llugë, Lluzhan, Majac, Merdar, Peran, Sfeçël, Surkish, Shajkoc, Shtedim, Tërnavë, Letanc
51% -80% e amvisërive me shërbim	Buricë, Dumnicë e Epërme, Kunushec, Lupç i Poshtëm, Lladoc, Penuh, Rep, Sallabajë, Katunishtë, Zakut
81% - 100% e amvisërive me shërbim	Godishnjak, Podujevë, Siboc i Poshtëm, Shakovicë

Bazuar në PZHK-në, ajo ka përcaktuar shtrirjen e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në tri nën-qendrat – qendrat bazike: Kërprimëh, Lluzhan dhe Orllan dhe krahas grumbullimit të mbeturinave njëkohësisht DPUMM duhet të aplikojë masat ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Plani i referohet edhe largimit të deponive ilegale. Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK gjatë dy viteve të zbatimit të PZHK-së, ka pasur investime në teknologji për grumbullimin e mbeturinave. Sipas Planit lokal për menaxhimin e mbeturinave (PLMM) për periudhën 2017-2022, ofrimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në komunën e Podujevës do të trajtohet sipas prioriteteve të prezantuara në tabelën e mëposhtme.

Tabela 15. Zonat Funktionale për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Podujevës

Zona	Njësia	Nr.i popullsisë	Nr. amvisëriv e me shërbim pa shporta	Nr.i amvisërive në të ardhmen
Zona A Prioritet 1	Bajçinë, Bellopojë, Bradash, Dobërdol, Dumosh, Gllamnik, Halabak, Kërpimeh, Kunushec, Letanc, Lupi Poshtëm, Llapashticë e Epërme, Llapashticë e Poshtme, Obrançë, Peran, Podujevë, Sfeqël, Surkish, Shajkocv, Shtedim, Katunisht, Zakut	57638	5290	3674
Zona B Prioritet 2	Ballovc, Batllavë, Buricë, Dobratin, Dumnicë e Epërme, Gërdoc, Godishnjak, Kaçybeg, Livadicë, Lladoc, Llaushë, Llugë, Lluzhan, Majac, Merdar, Metehi, Orllan, Penuhë, Pollatë, Radujevc, Repë, Revuq, Sallabajë, Siboc i Epërm, Shakovicë, Tërnavë	22182	1125	2188
Zona C Prioritet 3	Bërvenik, Bllatë, Breçë, Dvorishtë, Hërticë, Metergoc, Muhazob, Murgull, Potok, Rakinicë, Sllatinë, Surdull, Sylevicë, Tërnavicë, Turicë	8769	196	982
Totali		88589	6611	6844

Ka disa aktivitete që bëjnë kompanitë private, ku mund të përmendim riciklimin e plastikës, e cila përdoret për prodhimin e foljes së najlonit, i lokalizuar në fshatin Peran nga kompania “Plastika” sh.p.k. si dhe grumbullimin e kartonit (letrës) nga kompani “Natyra.

Në deponit sanitare të menaxhuara nga KMDK-ja: Dumnicë (Podujevë), deponimi i mbeturinave në vitin 2021 ka shënuar një rritje prej 35 000 ton, apo 9.3% më shumë krahasuar me vitin 2020 (AMMK 2021)

Sasia e mbeturinave të grumbulluara bartet në lokacionin e deponisë në Dumnicë, e ndërtuar nga AER në vitin 2005. Ajo menaxhohet nga Kompania e Deponive në Kosovë (KMDK), i cili është një organ shtetëror. Sipërfaqja e deponisë është 18ha. Në këtë deponi depozitohen mbetjet e Komunës së Podujevës (rreth 850 ton mbetje në muaj) që gjenerohen nga amvisëritë dhe

industrië komerciale. Kjo deponi nuk i plotëson standardet, pasi uji rrjedh vazhdimisht në sipërfaqen e tokës (nuk mblidhet dhe as nuk trajtohet), duke paraqitur një rrezik të vërtetë për lokalitetin. Ndërkohë aty nuk bëhet asnjë klasifikim apo ndarje të mbeturinave, dhe gazrat lëshohen në mënyrë të pakontrolluar. Pagesa për këtë deponi është 6€/ton, faturë e cila paguhet nga kompania.

Bazuar në raportin e gjendjes së mjedisit në Kosovë nga AMMK në deponitë sanitare të Dragashit dhe të Podujevës, deponohen mbeturinat e gjeneruara vetëm në komunat gjegjëse. Në deponinë e Podujevës, në vitin 2021 kemi një rritje të deponimit prej 1,598.45 ton, krahasuar me vitin 2020 (AMMK 2021).

Kurse sa i përket tarifave të mbeturinave Komuna e Podujevës vazhdon të zbatojë sistemin e tarifave të mbeturinave për kategoritë e konsumatorëve, të përcaktuar më 2013 (duke marrë parasysh vetëm ndryshimet e TVSH-së)


- Ø Amvisëritë – 4.70 €/ muaj;
- Ø Bizneset komerciale – 5.05 €/ muaj;
- Ø Bizneset industrial – 6.51 €/ muaj;
- Ø Institucionet – 12.42 €/ muaj.

Grumbullimi i tarifës kryhet në tre mënyra të ndryshme:

- Ø Grumbullimi derë më derë nga ofruesi i shërbimit;
- Ø Pagesa nga qytetarët në zyrën e ofruesit;
- Ø Zyrtari i inkasimit vjen derë më derë për grumbullimin e tarifës.

Në vendbanimet rurale të Komunës ekzistojnë shumë deponi të egra, shpesh herë nga 2-3 në çdo vendbanim. Nga këto deponi ilegale, edhe pse nuk janë në mbikëqyrje të kompanisë, shpesh herë me iniciativë të Komunës bëhet grumbullimi i tyre dhe bartja në deponinë qendrore ku çmimi për një ton është 6 €/ton. Kjo kosto e pranimit të mbeturinave në deponi paguhet nga kompania. Në rastin e deponive ilegale ato largohen vazhdimisht nga Komuna në bashkëpunim me kompanitë, në aksione të ndryshme, por përsëri ato krijohen nga qytetarë të ndryshëm. Në këtë Komunë ka shumë deponi ilegale të mbeturinave të hekurit dhe baterive, të cilët janë në numër të madh dhe në vende të ndryshme pranë rrugëve magjistrale, afër vend banimeve. Të gjithë këto operatorë nuk kanë leje nga Komuna dhe as licencë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Këto lloj deponish (të hekurit dhe baterive) duhet të regjistrohen dhe t’ju nënshtrohen kritereve të


punës, në të kundërt duhet të mbyllen. Nga një studim i kryer nga Komuna Podujevë, janë evidentuar 43 deponi të egra në të gjithë territorin saj. Pjesa më e madhe e këtyre deponive është e përqendruar në pjesën qendrore të komunës (PLMMK Podujevë 2017-2022).



Grafikoni 4. Llojet e mbeturinave në deponitë ilegale në territorin e komunës

Gjatë analizës evidentuese që është kryer, të dhënat për deponi ilegale janë ndarë në tre kategori: i) sipas llojit të mbeturinave që kanë; ii) sipas sipërfaqes që zënë; dhe iii) sipas numrit të qeseve të mbeturinave që kanë.

Bazuar në hartën e përhapjes hapësinore të deponive ilegale në territorin e komunës së Podujevës shihet që pjesa më e madhe e këtyre deponive është në pjesën **qendrore** po ashtu në pjesën jugore të komunës, kryesisht rreth shtretërve të **lumenjve**, rrugëve e rrugica publike si dhe sipërfaqe të pa shfrytëzuara aktualisht.



Harta 11. Deponitë Ilegale të Mbeturinave në komunën e Podujevës

Në rastin e deponive ilegale ato largohen vazhdimisht nga Komuna në bashkëpunim me kompanitë, në aksione të ndryshme, por përsëri ato krijohen nga qytetarë të ndryshëm. Në këtë Komunë ka shumë deponi ilegale të mbeturinave të hekurit dhe baterive, të cilët janë në numër të madh dhe në vende të ndryshme pranë rrugëve magjistrale, afër vend banimeve. Të gjithë këto operatorë nuk kanë leje nga Komuna dhe as licencë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Këto lloj deponish (të hekurit dhe baterive) duhet të regjistrohen dhe t’ju nënshtrohen kritereve të punës, në të kundërt duhet të mbyllen.

Tabela 16. Shfrytëzimi i tokës në ha

Hapësirat	ha	%
Pyje	29680.8	47.21
Bujqësia	18764.8	29.85
Vendbanimet	2589	4.12
Varrezat	77.33	0.12
Livadhe	3526	5.61
Kullosa	7293.8	11.6
Deponi për Mbeturina	61.6	0.1
Hapësira të lira	80.06	0.13
Degradim	47.05	0.07
Liqe	257.5	0.41
Lumenjë	77	0.12
Rrugë	415.86	0.66
Gjithsej	62870.8	100

